



Bankieri

Botim Nr. 32
Korrik 2019

ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



BANKAT DHE ZHVILLIMI I QENDRUESHËM

Përdorni kartat bankare për pagesat tuaja!
Më thjeshtë, më shpejt dhe pa komision.



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

ANËTARËT E AAB-së

PËRMBAJTJA

Bankieri

Nr.32, Korrik 2019

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave



REDAKSIA:

Elvin Meka

Kryeredaktor

Eftali Peçi

Koordinatorë Produksioni

Junida Tafaj (Katrosi)

Bashkëpunëtore

Dorina Zarka

Fotografe**Design & Layout:** FCB Afirma**Shtypi nga:**  Gent-grafik

Bankieri është publikimi zyrtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave i cili i dedikohet kryesisht sektorit bankar shqiptar. Bankieri i jep lexuesit një informacion të vlefshëm mbi arritjet e industrisë në përgjithësi dhe të bankave tregtare në veçanti.

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Rr. Ibrahim Rugova,

SKY TOWER, 9/3, Tiranë

Tel: +355 4 2280371/2

Fax: +355 4 2280 359

www.aab.al

Editorial

Zhvillimi dhe Financat e Qëndrueshme, treni që do marrin së shpejti dhe bankat në Shqipëri
Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA

4

Tema e Ditës

Vendosja e industrisë bankare në pararojë të agjendës së zhvillimit të qëndrueshëm
Puleng Tumelo NDJWILI-POTELE

6

Roli i bankave për financa të qëndrueshme, nga këndvështrimi i Federatës Bankare Evropiane

Sébastien de BROUWER

8

Zhvillimi i financave të qëndrueshme: Konkluzione të Rrjetit të Bankave Qendrore për Sisteme Financiare të Gjelbra

Sean GOODIER

Dejan VASILJEV

11

Bankat në një univers të ndërmjetësimit financiar në transformim e sipër
nga McKinsey

13

Banka Evropiane e Investimeve dhe financat e qëndrueshme

Ines HOB DARI

Alessandro BRAGONZI

16

Kriza ndërkombëtare e 2007/2008-ës pati një ndikim të vogël: Kriza greke dhe goditje të fortë
Prof. Charoula APALAGAKI

19

Tregu i huave me probleme dhe rritja e kreditimit në Republikën e Serbisë
Vladimir VASIĆ

23

Sistemi Bankar

OTP BANK Albania - Një bankë ambicioze për zhvillimin e tregut bankar shqiptar
Bledar SHELLA

27

Tirana Bank - Konsolidimi dhe rritja e mëtejshme, objektivat për 2019

Dritan MUSTAFA

28

Forumi i Ekspertëve

Tri strategji efektive për të luftuar ekonominë informale
Vladimir DJORDJEVIC

30

BAZEL III dhe ndikimi i tij në sektorin bankar

Rajmond PAVACI

32

Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm

34

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) feston 20-vjetorin e themelimit

39

Shoqata Shqiptare e Bankave organizon konferencën me temë "Bankat për zhvillim të qëndrueshëm"

41

AAB: Aktivitete

44

AAB: Trajnime

45

BORDI EDITORIAL:

Silvio PEDRAZZI

Kryetar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Intesa Sanpaolo Bank Albania

Andi BALLTA

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, American Bank of Investments

Hysen ÇELA

Kryetar i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Maltin KORKUTI

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Credins Bank

Ervin KOÇI

Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare

Spiro BRUMBULLI

Sekretar i Përgjithshëm, Shoqata Shqiptare e Bankave

Dritan MUSTAFA

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Tirana Bank

Adrian CIVICI

Dekan Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë



Mos kërkto gjat' për Bankomat!

Tërhiq 3 herë/muaj me **0 komision**,
në ATM-të e bankave të tjera brenda vendit



Zhvillimi dhe Financat e Qëndrueshme

Treni që do marrin së shpejti dhe bankat në Shqipëri

Sfida më e fortë për bankat është rimodelimi dhe formësimi i vizionit tradicional "afatshkurtër" për ecurinë dhe përfitueshmërinë, drejt atij "afatgjatë" dhe më të përgjegjshëm nga pikëpamja sociale, që do t'i shërbejë më mirë brezave të ardhshëm.



Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA¹
Kryeredaktor

Çështja e Zhvillimit të Qëndrueshëm, e më pas, koncepti i 'Financave të Qëndrueshme, filloi të zhvillohet, të paktën zyrtarisht, që nga 1992 në Samitin e Tokës në Rio de Janeiro, Brazil (në qershor 1992), ku më shumë se 178 vende miratuan Agenda 21, një plan veprimi gjithëpërfshirës për ndërtimin e një partneriteti global për zhvillim të qëndrueshëm, për përmirësimin e jetës në planet dhe për mbrojtjen e mjedisit. Çështja vijoi të zhvillohej më tej, deri në vitin 2015, kur OKB-ja miratoi 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), që shënojnë një kthesë cilësore, për institucionet financiare dhe jo vetëm, në drejtim të trajtimit dhe përfshirjes aktive të mjedisit dhe rreziqeve të tjera të lidhura me klimën, në veprimtarinë e përditshme. Përtej veprimtarive tradicionale të përgjegjshmërisë sociale të bankave, të fokusuara në OZHQ-të dhe tema të veçanta rreth mjedisit, deri tani janë jetësuar

disa nisma ndërkombëtare, që përdorin konceptin "e gjelbër" dhe të "qëndrueshëm", si: Nisma Financiare e OKB-së për Programin Mjedisor (UNEP FI) dhe Parimet për Banking të Përgjegjshëm, emetimi i obligacioneve të gjelbra, nga bankat e zhvillimit dhe sektori privat, etj.

Pokundodhen bankat në Shqipëri, në këtë peizazh të "qëndrueshëm, mjedisor dhe të gjelbër"? Bankat në Shqipëri kanë qenë shumë të vëmendshme dhe të interesuara ndaj zhvillimit të përgjegjshmërisë sociale të korporatës (CSR), duke investuar fonde, përpjekje dhe energji të konsiderueshme, për vite me radhë. Gjatë viteve të fundit, ato kanë përshtatur CSR-të e tyre tërësisht përmes OZHQ-ve. Gjithashtu, disa banka kanë promovuar dhe përdorur, për vite me radhë, një numër të kufizuar idesh dhe produktesh "eko" dhe "të gjelbra". Megjithatë, bankat në Shqipëri kane ende një rrugë të gjatë për të bërë, në drejtim të mishërimit të parimeve të zhvillimit dhe financave të qëndrueshme, në veprimtarinë natyrale të biznesit të tyre. Ajo që mund të shihet si "pozitive" në këtë drejtim është se, me shumë pak përjashtime, ky është realiteti për shumicën e vendeve, madje edhe për ato me ekonomi shumë më të përparuar dhe të sofistikuar se sa Shqipëria.

Pavarësisht kësaj, ky realitet nuk do të zgjasë shumë, as në botë, e as në Shqipëri. Zhvillimi & Financat e Qëndrueshme është një tren, që bankat në Shqipëri, në mënyrë të pashmangshme do ta marrin së shpejti, pasi rreziqet klimatike e mjedisore dhe ekonomia nuk janë

më çështje të izoluara dhe me natyrë kombëtare; ato nuk mund të kufizohen dhe kontrollohen në kufijtë shtetërorë individualë. Thënë kjo, dita kur bankat në Shqipëri do të konsiderojnë zhvillimin e veprimtarisë së tyre në përputhje me financat e qëndrueshme po afron; po kështu po afron dhe sfida me të cilën ato duhet të përballen. Këtu sfida është rimodelimi dhe formësimi i vizionit tradicional "afatshkurtër", për ecurinë dhe përfitueshmërinë, drejt atij "afatgjatë" dhe më të përgjegjshëm nga pikëpamja sociale, që do t'i shërbejë më mirë brezave të ardhshëm. Kjo do të kërkonte përpjekje të zellshme drejt hartimit dhe përdorimit të produkteve specifike, të lidhura në mënyrë aktive me mjedisin, klimën dhe qëndrueshmërinë. Sigurisht, bankat nuk mund ta bëjnë këtë gjë vetëm; rregullatorët e sistemit financiar, madje edhe qeveria (qendrore dhe vendore) mund të ndihmojnë shumë në këtë drejtim, nëpërmjet rregulloreve (kërkesa të zbutura për produktet bankare "të gjelbra"), politikave tatimore (trajtimi preferencial tatimor për investime në instrumente "të gjelbra" të emetuara nga sektori publik dhe privat), emetimi i instrumenteve "të gjelbra" (sidomos nga qeverisja lokale dhe korporatat), etj. Ekonomia, klima dhe mjedisi janë çështje e të gjithëve, përfshirë këtu bankat si lojtarët kyç në këtë drejtim!

¹Dekan i Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, Universiteti Europian i Tiranës, UET

Vendosja e industrisë bankare në pararojë të agjendës së zhvillimit të qëndrueshëm

Banka do të duhet të identifikojë dhe vlerësojë ndikimet e saj më të rëndësishme sociale, ekonomike dhe mjedisore, si pozitive ashtu dhe negative, që rezultojnë nga veprimtaritë, produktet dhe shërbimet e saj, si dhe të përcaktojë objektivat që synojnë harmonizimin e këtyre ndikimeve me objektivat dhe synimet e parashikuara në OZHQ-të, Marrëveshjen e Parisit për Klimën dhe korniza të tjera në këtë aspekt.



Puleng Tumelo NDJILI-POTELE

Koordinator e Projektit Bankar, Nisma Financiare e OKB-së për Programin Mjedisor – UNEP FI

Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm vazhdon të arritet, në aspektin e rëndësisë dhe urgjencës. Bota po ballafaqohet aktualisht me sfida të forta, që përfshijnë zhvillimin ekonomik, ndryshimet klimatike, degradimin e mjedisit, varfërinë, pabarazinë dhe përfshirjen financiare. Financimi aktual për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ - SDG) është i pamjaftueshëm dhe i keq koordinuar, ndërkohë që raporti i fundit i IPCC dëshmon se ngrohja globale duhet mbajtur nën 1,5 gradë Celsius, në mënyrë që të shmangen pasojat e rënda dhe të pakthyeshme në planet dhe në jetën tonë.

Bankat, si ofrueset kryesore të financimeve në vendet e tyre, kanë ndikim të rëndësishëm mbi atë çka financohet, duke i vendosur ato në një pozicion të përshtatshëm për të dhënë kontribute të rëndësishme drejt arritjes së OZHQ-ve, Marrëveshjes së Parisit për Klimën dhe qëllimeve të politikave kombëtare. Bankat që nuk arrijnë të japin kontribute të konsiderueshme për nevojat dhe qëllimet e shoqërive të tyre do ta kenë gjithnjë e më të vështirë të mbeten konkurrese dhe të rëndësishme në një klimë ku grupet e interesit (përfshirë këtu rregullatorët, shoqëritë civile, investuesit, konkurrentët) vazhdimisht i sfidojnë ata për t'u treguar atyre se si janë po i përgjigjen sfidave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe si po i menaxhojnë rreziqet që mund të destabilizojnë bizneset e tyre, e rrjedhimisht dhe ekonomitë e tyre. Për të ndërtuar besimin te grupet e interesit dhe komunitetet e tyre, bankat duhet të gjenerojnë vlerë për shoqëritë e tyre, ndërkohë që realizojnë fitime për aksionarët e tyre.

Parimet për Banking të Përgjegjshëm ofrojnë udhëzime për bankat për nxitjen e huadhënies, që kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm. Këto parime vullnetare ofrojnë një kornizë gjithëpërfshirëse, që do t'i ndihmojë bankat të mishërojnë qëndrueshmërinë në të gjithë

veprimtaritë e tyre, që nënkupton se mirëqenia e njerëzve dhe e planetit janë në thelb të vendimmarrjes dhe veprimtarive të tyre. Parimet janë formësuar nga 28 banka kryesore, që përfaqësojnë rreth 17,000 miliardë dollarë në aktive të kombinuara, së bashku me Nismën Financiare të OKB-së për Programin Mjedisor (UNEP FI). Ato janë hartuar në mënyrë të tillë që i japin mundësi çdo banke që të regjistrohet në to, pavarësisht nga niveli i përvojës së saj me financat e qëndrueshme.

Të gjashtë Parimet kërkojnë që strategjia e biznesit të bankës të jetë e orientuar drejt kontributit ndaj OZHQ-ve, Marrëveshjes së Parisit për Klimën dhe kornizave të tjera të përshtatshme kombëtare, ose rajonale. Bankat duhet të kenë një qasje holistike ndaj ndikimeve të tyre, duke vlerësuar ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta, përkrah përpjekjeve për rritjen e ndikimeve të tyre pozitive, duke zvogëluar ndikimet negative që lidhen me operacionet dhe veprimtaritë e tyre huadhënëse, ndërkohë që duhet të menaxhojnë dhe minimizojnë rreziqet e tyre. Ndikimet më të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e një banke përgjithësisht do të jenë të rrënjësura në huadhënien e saj, e për këtë arsye, bankat duhet të punojnë me klientët dhe konsumatorët e tyre për arritjes e rezultateve më të qëndrueshme,

si dhe të angazhohen dhe/ose hyjnë në partneritet me aktorë të tjerë, për të përshpejtuar ndikimin pozitiv. Bankat duhet të sigurojnë që strukturat dhe proceset e qeverisjes së tyre të jenë të mjaftueshme për përmbushjen e angazhimeve të tyre ndaj këtyre Parimeve. Së fundi, Parimet kërkojnë transparencë dhe llogaridhënie nga bankat, përmes raportimit publik mbi progresin e arritur prej tyre në zbatimin e Parimeve.

Një rrugë e fuqishme për bankat, për të demonstruar dhe përmirësuar në mënyrë progresive kontributin e tyre në zhvillimin e qëndrueshëm, është vendosja e objektivave që trajtojnë ndikimet më të rëndësishme të bankës. Banka do të duhet të identifikojë dhe vlerësojë ndikimet e saj më të rëndësishme sociale, ekonomike dhe mjedisore, si pozitive ashtu dhe negative, që rezultojnë nga veprimtaritë, produktet dhe shërbimet e saj, si dhe të përcaktojë objektivat që synojnë harmonizimin e këtyre ndikimeve me objektivat dhe synimet e parashikuara në OZHQ-të, Marrëveshjen e Parisit për Klimën dhe korniza të tjera në këtë aspekt. Legjitimiteti i Parimeve rrjedh nga mekanizmat e llogaridhënies dhe transparencës. Bankat duhet të raportojnë publikisht rreth zbatimit nga ana e tyre të Parimeve, duke përfshirë dhe ndikimet pozitive dhe negative, rreziqet dhe objektivat e tyre. Ky raportim do t'i nënshtrohet një procesi vlerësimi, me pasoja për bankat që vazhdimisht dështojnë të tregojnë progres me kalimin

e kohës. Duke pranuar faktin se, bankat gjenden në faza të ndryshme në rrugën drejt financave të qëndrueshme, ato do të kenë kohë deri në katër vjet që të bëhen nënshkruese të Parimeve, për të zbatuar të gjitha kërkesat e këtyre të fundit.

Më shumë se 70 banka i kanë miratuar tashmë Parimet, duke u angazhuar që të bëhen nënshkruese të Parimeve për Banking të Përgjegjshëm. Këto banka janë pjesë e një komuniteti në rritje të bankave anëtare të UNEP FI-së, që janë të angazhuar për financa të qëndrueshme.



Bankat, si ofrueset kryesore të financimeve në vendet e tyre, kanë ndikim të rëndësishëm mbi atë çka financohet, duke i vendosur ato në një pozicion të përshtatshëm për të dhënë kontribute të rëndësishme drejt arritjes së OZHQ-ve, Marrëveshjes së Parisit për Klimën dhe qëllimeve të politikave kombëtare.



Ato do të përfitojnë nga ndarja e njohurive dhe përvojës së tyre me njëra-tjetrën, nga mbështetja dhe udhëzimet e Sekretariatit të UNEP FI-së, sikundër dhe ekspertët e këtyre çështjeve, duke u siguruar bankave qasje të drejtpërdrejtë

në njohuritë, mjetet dhe burimet e ekspertëve, për t'i ndihmuar ato në rritjen e kapaciteteve dhe forcimin e pozicionit të tyre si udhëheqëse për financa të qëndrueshme. Këtyre banka u janë bashkuar dhe 26 aktorë, që përfshijnë rregullatorë, shoqata bankash dhe organizata të shoqërisë civile, të cilët kanë miratuar Parimet, duke shfaqur mbështetjen e tyre për to.

Parimet kanë kaluar përmes një procesi të gjerë konsultimi gjashtë mujor, gjatë të cilit bankat, investuesit, rregullatorët dhe shoqëria civile, ndër të tjera, dhanë kontribute me vlerë e që sigurojnë që Parimet përfaqësojnë një pikë referimi globale për një sistem bankar të qëndrueshëm, i përshtatshëm për shekullin e 21-të. Drejtorët ekzekutivë të bankave që angazhohen të bëhen nënshkruese të Parimeve do të mblidhen në selinë e OKB-së në Nju Jork, gjatë Asamblesë së Përgjithshme të saj, për të nënshkruar Parimet për Banking të Përgjegjshëm, duke u bërë zyrtarisht Firmëtarët Themelues të Parimeve. Parimet janë të dizajnuar për të shfrytëzuar potencialin që industria bankare ka në drejtim të përmbushjes së OZHQ-ve, Marrëveshjes së Parisit për Klimën dhe qëllimeve të politikave kombëtare, duke krijuar kështu një ekonomi më të fortë globale dhe një botë më të mirë për të gjithë, kudo. Ne ju inkurajojmë të përfshihen!

Mësoni se si banka juaj mund të bëhet nënshkruese e Parimeve për Banking të Përgjegjshëm në:

www.unepfi.org/responsiblebanking.



Roli i bankave për financa të qëndrueshme, nga këndvështrimi i Federatës Bankare Evropiane

Qëllimi duhet të jetë një sistem financiar në të cilin të gjitha përfitimet (financiare, shoqërore dhe mjedisore) të jenë të skalitura përfundimisht. Me të arritur këtë, nuk do të na duhet të flasim më për financa të qëndrueshme, pasi si rregull, të gjitha financat do të jenë të qëndrueshme.



Sébastien de BROUWER

Drejtor i Përgjithshëm i Politikave
FEDERATA BANKARE EVROPIANE,
EBF-FBE

Tashmë ekzistojnë prova të padiskutueshme shkencore rreth ngrohjes globale dhe efektet negative të saj po ndihen tashmë në të gjithë botën. Ndryshimi aktual i klimës do të ketë një ndikim të fortë në ekonomi, shoqëri dhe në tregje. Të tjera të dhëna gjithnjë e më evidente po dëshmojnë se ndryshimet klimatike dhe rreziqet mjedisore kanë pasojë të rëndësishme mbi stabilitetin financiar, fakt ky që nuk mund të shpërfillet. Rritja e vetëdijes rreth këtij ndikimi i ka detyruar qeveritë të veprojnë, nëpërmjet Marrëveshjes së Parisit, për zbatimin e politikave për të kufizuar rritjen globale të temperaturave deri në 2°C, e mundësisht deri në 1.5°C.

Përtej reflektimit mbi rreziqet, kjo kërkon investime masive dhe rishpërndarje të kapitalit. Vetëm për Evropën vlerësohet një hendek i qëndrueshmërisë së investimeve prej 180 miliardë euro në vit. Rritja e ndërgjegjësimit i ka sjellë Financat e Qëndrueshme në qendër të agjendës aktuale politike në Evropë. Bashkimi Evropian është i angazhuar për të luajtur një rol udhëheqës në luftën globale kundër ndryshimeve klimatike. Synimi është që Evropa të bëhet tregu më i përparuar i kapitaleve, ku shoqëritë dhe investuesit e vegjël të nxiten (nëpërmjet instrumenteve dhe zgjidhjeve digjitale) për t'i zhvendosur investimet e tyre drejt projekteve ekologjike miqësore, duke kontribuar kështu në agjendën e BE-së për zhvillim të qëndrueshëm dhe neutrale ndaj karbonit. Në këtë kuadër, Komisioni Europian miratoi vitin e kaluar, në mars 2018, një Plan Veprimi ambicioz për Financat e Qëndrueshme, i cili u pasua nga tre propozime legjislative (për taksonominë, kërkesat e ekspozimit (publikimit) dhe parametrave (referencave) financiare). Ky plan i hap rrugë riorientimit të rrjedhave të kapitalit drejt investimeve të qëndrueshme, si dhe i bashkëngjijt sektorit financiar konceptin e investimeve afatgjata, të shtrira në kohë. Gjithashtu, ai synon menaxhimin e rreziqeve në sistemin

financiar, që vijnë nga ndryshimet klimatike.

Sidoqoftë, sektori publik nuk mund ta bëjë i vetëm atë. Siç thekson dhe V. Dombrovskis, Zëvendës President për Dialogun Evropian dhe Social, Stabilitetin Financiar, Shërbimet Financiare dhe Bashkimin e Tregjeve të Kapitalit: "Sektori financiar duhet të përqendrojë të gjithë forcat në luftën kundër ndryshimeve klimatike. Kjo është një sfidë, por gjithashtu edhe një mundësi e jashtëzakonshme. Në vitet e ardhshme, bankat dhe institucionet financiare të Evropës kanë një mundësi për të nxitur zhvillimet globale drejt financave të qëndrueshme. Duke lëvizur drejt një ekonomie të bazuar në teknologji me karbon minimal dhe efikasitetin e buriemeve, ne mund të nxisim krijimin e vendeve të punës, produktivitetin dhe mirëqenien e qytetarëve tanë." Të dy sektorët, ai publik dhe privat, duhet të punojnë së bashku për të arritur ndryshimet e synuara. Transformimi mund të arrihet vetëm nëse bankat marrin një rol aktiv, pasi investimet e mëdha kanë nevojë të financohen. Kjo është veçanërisht e vërtetë në Evropë, ku bankat financojnë mbi 2/3 e ekonomisë. Konkretisht, kur është fjala për Financa të Qëndrueshme, neve në EBF besojmë te 4 "E"-të: **Mundësimi, Inkurajimi, Angazhimi dhe Edukimi**¹.

¹ Enabling, Encouraging, Engaging and Educating.

Mundësimi

Drejtimi i Komisionit Evropian e ka përsheptuar ndjeshëm agjendën e zhvillimit të qëndrueshëm në të gjithë Evropën. Gjithsesi, veprimet vullnetare dhe lëvizjet me karakter demonstrativ nga institucionet dhe bizneset kryesore, nuk janë të mjaftueshme jo vetëm për të mobilizuar fonde në masën dhe ritmin e kërkuar, por edhe për të transformuar të gjithë aspektet e shoqërisë sonë. Këtu ka nevojë për aksion publik, për t'i ndihmuar bankat dhe tregjet që t'i kanalizojnë financimet drejt qëllimeve shoqërore të dobishme. Nismat private janë të mëdha, por ato duhet të plotësohen nga korniza inteligjente rregullatore, që fashitin pasiguritë, sigurojnë krahasueshmëri dhe lejojnë zgjidhje konkurruese, që **mundësojnë** financimin e tranzicionit drejt ekonomive më të qëndrueshme, në një fushë loje me rregulla të barabarta. Kjo është arsyeja pse EBF përkrah Planin e Veprimit të Komisionit Evropian për Financa të Qëndrueshme.

Inkurajimi

Mundësimi nuk është i mjaftueshëm, nëse tregjet nuk mobilizohen në madhësinë dhe shpejtësinë e kërkuar. Realisht, po dalin në dritë kërkime dhe fakte pozitive mbi ecurinë, si në aspektin e rrezikut dhe të përfitueshmërisë së investimeve të qëndrueshme. Drejtuesit e shoqërive që ndjekin kriteret Mjedisore, Sociale dhe të Qeverisjes (ESG²) janë jo vetëm në pozicionin për të parashikuar në mënyrë efikase rreziqet dhe mundësitë që lidhen me klimën, por ata presin që kostot e kapitalit dhe huamarrjes të ulen më tej. Shoqëritë që ndjekin ESG-të e që janë të mirë klasifikuara kanë kapital aksionar dhe obligacione më pak të luhatshme, si dhe ecuri më të

mirë. Shoqëritë tregtare inteligjente, që përdorin strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm, po fitojnë avantazhe konkurruese, shpesh me ndihmën e teknologjive novatore. Nga krahu i kërkesës, shumica e investuesve të vegjël synojnë të investojnë në mënyrë të qëndrueshme. Përkundër këtyre zhvillimeve pozitive, ende flitet për një hendek të konsiderueshëm investimesh financiare. Në fakt nuk ka mungesë kapitali, por çështja është te riorientimi i rrjedhave të



Plotësimi i MREL paraqet një sfidë për vende si Shqipëria, për shkak të kapacitetit të tregut vendas për të përthithur (blerë dhe mbajtur) borxhin e varur, që mund të shërbejë për plotësimin e kërkesës minimale si dhe të kapacitetit të vetë bankave për ristrukturimin e burimeve të financimit, të cilat përbëhen aktualisht, në një masë të gjerë, nga depozitat.



fondeve aty ku ndikimi do të bëjë dallimin më të madh.

Ndërsa mungesa e taksonomisë dhe e të dhënave, sikundër dhe infrastruktura e pamjaftueshme, mund të ndikojnë negativisht në madhësinë e synuar të tregjeve, duhet rishikuar kuadri ligjor dhe jo-ligjor, për të **inkurajuar dhe shpërblyer** kalimin drejt ekonomisë së qëndrueshme. EBF po përgatit një raport që do të përqendrohet në një numër të kufizuar nxitësish, me synimin për të rritur financat e qëndrueshme në sektorin bankar.

Qasja e zgjedhur vlen për një numër të kufizuar nxitësish, që gjykohen si më të përshtatshëm nga perspektiva bankare. Titullizimi i gjelbër, rishikimi i trajtimit të kujdesshëm të aktiveve të qëndrueshme, ku ka sinjale për rrezik më të ulët, si dhe ndërhyrja publike në formën e garancive, lehtësive fiskale dhe subvencioneve, mund të kontribuojë fort në rritjen e veprimtarive të qëndrueshme dhe financimin e tyre. Raporti do të publikohet gjatë muajve në vijim, në mbështetje të refleksioneve të Komisionit dhe Parlamentit Evropian, si dhe Autoritetit Bankar Evropian (EBA), i cili mund ta përdorë si një bazament për raportin e tij mbi trajtimin e kujdesshëm të aktiveve të qëndrueshme/paqëndrueshme.

Angazhimi

Bankat po veprojnë së bashku, për të siguruar përparësi dhe për të përforcuar përpjekjet individuale. Për shembull, 28 bankat kryesore anëmbanë botës, përfshirë 9 banka nga Evropa, hartuan në bashkëpunim me UNEP FI Parimet për Bankingun e Përgjegjshëm. Këto parime i kalibrojnë bankat sipas objektivave të shoqërisë, siç parashihen edhe në Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG) dhe në Marrëveshjen e Parisit për Klimën. EBF ishte ndër mbështetësit dhe promovuesit e parë të këtyre Parimeve, të cilët kanë një potencial të madh për përsheptimin e kalimit të sektorit bankar, e më tej edhe të gjithë ekonomisë, drejt një rruge zhvillimi të qëndrueshëm. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe veçanërisht ndryshimi i klimës, nuk do të lënë asnjë sektor të paprekur. Rrjedhimisht, ekziston nevoja për të thelluar dialogun mes grupeve interesit, përfshirë këtu klientët e bankave në nivel evropian, për të kuptuar ndikimin e "agjendës

¹ ESG - Environmental, Social and Governance.

së zhvillimit të qëndrueshëm” në modelet, strategjitë dhe menaxhimin e rrezikut në bizneset përkatëse.

Duke mbledhur ekspertë nga e gjithë Evropa, Grupi i Punës së EBF-së për Financa të Qëndrueshme po përgatitet të **angazhohet** me aktorët dhe vendimmarrësit kryesorë për çështjet që lidhen me parimet ESG. Grupi i Punës është organizuar në mënyrë të tillë që t'i ofrojë Komisionit Evropian kontributin e duhur dhe në kohë, lidhur me aspektet kryesore të Planit të tij të Veprimit, veçanërisht lidhur me taksonominë, obligacionet, indekset dhe parametrat e gjelbër, si dhe nxitësit/frenuesit respektivë, si një aspekt shtesë dhe me interes kritik për bankat. Me një rëndësi të madhe konsiderohet dhe angazhimi me rregullatorët dhe mbikëqyrësit bankarë, për të rimenduar së bashku mënyrat se si sistemi financiar do t'i qaset qëndrueshmërisë, transparencës dhe rreziqeve

afatgjata. Ndërkohë që rreziqet e klimës po konsiderohen gjithnjë e më shumë si rreziqe financiare, nisur nga mungesa e të dhënave, dhe eksperiencia e mangët në drejtim të llogaritjes dhe modelimit të tyre, mbetet ende sfidë për menaxherët e rreziqeve për llogaritja e ndikimit financiar të këtyre rreziqeve. Thënë kjo, të dhënat dhe metodologjitë po shpërfaqen ngadalë, falë dhe ekspozimeve më të mëdha financiare, duke mundësuar përfshirjen e tyre progresive në menaxhimin e rrezikut dhe proceset e brendshme. Megjithatë, nevojitet ende shumë punë e përbashkët për të përmirësuar njohuritë mbi rreziqet e ESG-ve, për të identifikuar sfidat dhe për të punuar për zgjidhjet, si dhe për të krijuar partneritete me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe zhvillimin e kompetencave.

Kjo na sjell tek "E"-ja e fundit.

Edukimi

Edukimi financiar ka rëndësi në drejtim të fuqizimit të publikut me aftësi dhe kompetenca, që i ndihmojnë ata të ngrenë pyetjet e duhura dhe të bëjnë zgjedhjet e përshtatshme, lidhur me kursimet, investimet, përfshirë dhe rreziqet që lidhen me qëndrueshmërinë. Edukimi rreth qëndrueshmërisë duhet të përfshijë profesionistë të trajnuar rreth çështjeve financiare, për t'i ndihmuar ata të kuptojnë thellë rreziqet e qëndrueshmërisë, si dhe t'i masin, t'i integrojnë dhe t'i çmojnë më saktë ato. Këtu është i nevojshëm integrimi i mëtejshëm i ekspertëve të industrisë financiare në programet e trajnimit mbi mënyrat e qasjes ndaj qëndrueshmërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Qëndrueshmëria duhet të jetë pjesë integrale e proceseve dhe vendimmarrjes së përditshme, që nga drejtuesit e portofolit, te menaxherët e rrezikut, nga sallat e mbledhjeve të bordeve te këshilltarët financiarë.

Përfundim

Bankat kanë një rol të qartë dhe të rëndësishëm në financat e qëndrueshme. Ai konsiston në lidhjen e qëndrueshmërisë me objektivat financiare. Pavarësisht se do të duhet kohë dhe se aktorë të ndryshëm do ta gjejnë veten në stadi dhe nivele të ndryshme zhvillimi – duke adoptuar një qasje dhe ritëm të ndryshëm – përsëri prirja është tashmë e qartë. Qëllimi duhet të jetë një sistem financiar në të cilin të gjitha përfitimet (financiare, shoqërore dhe mjedisore) të jenë të skalitura përfundimisht. Me të arritur këtë, nuk do të na duhet të flasim më për financa të qëndrueshme, pasi si rregull, të gjitha financat do të jenë të qëndrueshme.



Zhvillimi i financave të qëndrueshme: Konkluzione të Rrjetit të Bankave Qendrore për Sisteme Financiare të Gjelbra¹

Rrjeti për një Sistem Financiar të Gjelbër u krijua në dhjetor 2017 nga tetë banka qendrore, përfshirë këtu, ndër të tjera, bankat qendrore franceze, gjermane, holandeze dhe britanike. Rrjeti – një "koalicion i vullnetit të mirë të bankave qendrore" – është zgjeruar tani me më shumë se tridhjetë anëtarë, duke përfshirë IFN-të vëzhguese, si: BERZH dhe Grupi i Bankës Botërore.



Sean GOODIER
FCA

Njohja e ndryshimeve klimatike si një rrezik financiar po nxit zgjerimin e financave të qëndrueshme – reforma legjislativë dhe rregullatore, të drejtuara nga Komisioni Evropian, veprimtaria e Institucioneve Financiare Ndërkombëtare (IFN) për zhvillimin e instrumenteve të financave të gjelbra dhe së fundi, krijimi i "Rrjetit për një Sistem Financiar të Gjelbër" (NGFS) – një koalicion i rëndësishëm i vullnetit të mirë të Bankave Qendrore, që po punojnë për një kuptim më të mirë të mekanizmave me anë të të cilave rreziqet klimatike dhe mjedisore ndikojnë në mandatet e tyre, por gjithashtu edhe në atë çka ato mund të bëjnë për të mbështetur kalimin drejt sistemeve financiare më të qëndrueshme.

Mandatet e bankave qendrore kanë ndryshuar thelbësisht, që nga kriza financiare e vitit 2008 dhe përgjegjësitë e tyre po fillojnë të zgjerohen së fundmi drejt fushës së ndryshimeve klimatike. Bankat qendrore janë të mirë pozicionuara për të marrë këtë rol nëpërmjet kapacitetit të tyre të dyfishtë: si rregullatorë – ku mund të testojnë aftësinë e bizneseve për t'u përballur me rreziqet klimatike dhe për të inkurajuar dhënien e informacioneve shpjeguese lidhur me klimën – dhe si rojtarë të stabilitetit financiar – duke mundësuar vendosjen e kërkesave për mjaftueshmëri

kapitali për institucionet, që marrin në konsideratë rreziqet e lidhura me klimën.

Megjithatë, rreziqet e lidhura me klimën kanë një numër tiparësh dalluese, të cilat të gërshetuara me njëra-tjetrën, nënkuptojnë që nevojitet një qasje strategjike për menaxhimin e tyre. Ndryshimi i klimës ka një shtrirje të gjerë dhe të thellë, i parashikueshëm si natyrë, i pasigurt në horizontin e tij kohor dhe i varur nga veprimet afatshkurtra, nisur nga fakti se madhësia e ndikimeve të ardhshme do të përcaktohet nga veprimet e sotme. Të kuptuarit dhe menaxhimi i natyrës së ndërlikuar të këtyre rreziqeve dhe pasojat e tyre për sistemin financiar kërkojnë bashkërendim midis bankave qendrore dhe autoriteteve kombëtare nga e gjithë bota. Sot ekziston nevoja për një leadership dhe veprime kolektive nga vende të ndryshme në botë.

Kështu – në dhjetor 2017 – u krijua Rrjeti për një Sistem Financiar të Gjelbër nga tetë banka qendrore, përfshirë këtu, ndër të tjera, bankat qendrore franceze, gjermane, holandeze dhe britanike. Rrjeti – një "koalicion i vullnetit të mirë të bankave qendrore" – është zgjeruar tani me më shumë se tridhjetë anëtarë, duke përfshirë IFN-të vëzhguese, si: BERZH dhe Grupi i Bankës Botërore.

NGFS synon të krijojë edhe nisma



Dejan VASILJEV
BERZH

¹ Ky artikull paraqet mendimet dhe opinionet personale të autorëve dhe jo ato të FCA-së, ose të BERZH-t.

të tjera ndërkombëtare, të cilat përqendrohen në rreziqet financiare që lidhen me klimën - përfshirë këtu Task Forcën për Dhënie të Informacioneve Financiare lidhur me Klimën, Grupin e Studimit për Financa të Gjelbra/të Qëndrueshme të G20-ës, si dhe nisma më të gjera, si: Marrëveshja e Parisit dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Brenda kontekstit të kësaj çështje, mekanizmat nëpërmjet të cilave rreziqet klimatike dhe mjedisore mund të ndikojnë në stabilitetin financiar, fatkeqësisht kuptohen fare pak - ky forum i bankave qendrore është në pararojë të zhvillimit të të kuptuarit të këtyre rreziqeve.

Rrjeti ka dy objektiva kryesore: të kontribuojë në analizimin dhe menaxhimin e rreziqeve klimatike dhe mjedisore në sektorin financiar dhe të mobilizojë financat në përgjithësi për të mbështetur tranzicionin drejt një ekonomie globale të qëndrueshme.

Në prill të këtij viti, NGFS publikoi raportin e tij të parë gjithëpërfshirës, i cili përmban gjashtë rekomandime kryesore për bankat qendrore, mbikëqyrësit dhe politikë bërësit, për të rritur rolin e tyre për një sistem financiar më të gjelbër. Këto pasqyrojnë praktikën më të mira, të identifikuar nga anëtarët e NGFS-së, për të lehtësuar rolin e sektorit financiar në mbështetjen për përmbushjen e objektiveve të Marrëveshjes së Parisit.

Së pari - dhe më e rëndësishmja - rreziqet që lidhen me klimën duhet të integrohen në monitorimin në nivel mikro të mbikëqyrjes dhe të stabilitetit financiar. Përpara se të ndodhë kjo, është thelbësore që rreziqet të tilla, të lidhura me klimën, të vlerësohen në mënyrë të mjaftueshme - dhe kjo përfshin si rreziqet fizike (vlera e aktiveve financiare të humbura, si pasojë e ndryshimeve klimatike dhe fatkeqësive natyrore) ashtu dhe rreziqet e tranzicionit (kostoja ligjore dhe e rregullimit që sektori financiar

do të paguajë për tranzicionin drejt një ekonomie me karbon të ulët). Kjo kërkon gjithashtu një angazhim të fortë me institucionet financiare, për të rritur ndërgjegjësimin për rreziqet financiare të lidhura me klimën dhe që janë në gjendje t'i identifikojnë, analizojnë dhe raportojnë ato.

Rekomandimi i dytë është që faktorët e qëndrueshmërisë duhet të integrohen në menaxhimin e portofolit. Këtu bankat qendrore duhet të udhëheqin me shembullin e tyre në veprimtarinë operacionale, duke integruar faktorë të tillë në



Rreziqet e lidhura me klimën kanë një numër tiparësh dalluese, të cilat të gërshetuara me njëra-tjetrën, nënkuptojnë që nevojitet një qasje strategjike për menaxhimin e tyre. Ndryshimi i klimës ka një shtrirje të gjerë dhe të thellë, i parashikueshëm si natyrë, i pasigurt në horizontin e tij kohor dhe i varur nga veprimet afatshkurtra, nisur nga fakti se madhësia e ndikimeve të ardhshme do të përcaktohet nga veprimet e sotme.



menaxhimin e portofoleve të tyre - gjithnjë duke marrë parasysh rregullimet e ndryshme institucionale në çdo juridiksion përkatës. Duhet të theksohet se Banka Popullore e Kinës është aktualisht i vetmi anëtar i NGFS-së që ka promovuar financat e gjelbra nëpërmjet politikës monetare të saj.

Së treti, autoritetet kombëtare duhet të ndajnë të dhëna të rëndësishme mbi Vlerësimin e Rrezikut të Klimës dhe mundësisht t'i bëjnë këto të disponueshme publikisht

në një bazë të dhënash. Kjo do të ndihmojë në kapërcimin e hendekut të të dhënave që aktualisht përbën një nga sfidat kryesore për mbikëqyrësit. E katërta është që bankat qendrore, mbikëqyrësit dhe institucionet financiare duhet të krijojnë vetëdije dhe kapacitete intelektuale brenda tyre, si dhe të inkurajojnë asistencën teknike dhe shkëmbimin e njohurive midis grupeve të interesit, për të përmirësuar të kuptuarin nga ana e tyre të faktit se si faktorët që lidhen me klimën përkthehen në rreziqe dhe mundësi financiare.

Dy rekomandimet e fundit u drejtohen bankierëve qendrorë, por dhe më gjerë, rregullatorëve. NGFS kërkon të sigurojë arrijë një ekspozim informacioni të qëndrueshëm dhe ndërkombëtarisht të njëtrajshëm për klimën dhe mjedisin, i cili të mund të jetë pjesë përbërëse e një tregu kapitalesh efikas dhe funksional, me një mekanizëm çmuarje efektiv për rreziqet që lidhen me klimën. Së fundmi, rrjeti inkurajon fort rregullatorët për të zhvilluar taksonomitë përkatëse, që synojnë lehtësimin e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të rreziqeve klimatike dhe mjedisore nga institucionet financiare, si dhe mobilizimin e kapitalit për investime të gjelbra dhe me karbon të ulët, në përputhje me Marrëveshjen e Parisit. Puna e Komisionit Evropian është një hap shumë pozitiv në këtë drejtim.

Pra cilat janë hapat e ardhshëm për NGFS-në? Ende nevojitet shumë punë analitike për të pajisur bankat qendrore dhe mbikëqyrësit me instrumentet që u duhen për të identifikuar, përcaktuar dhe menaxhuar rreziqet e ndryshimeve klimatike në sistemin financiar. Në një kuadër më të gjerë - rrjeti po synon të zgjerojë angazhimin e tij me grupet përkatëse të interesit, për të siguruar një shkëmbim reciprokisht të dobishëm të përvojës dhe informacionit.

Bankat në një univers të ndërmjetësimit financiar në transformim e sipër

Bankat ndodhen në qendër të një sistemi gjigand dhe kompleks, që ofron ndërmjetësim për rreth 260 trilion dollarë fonde në rrafsh global. Çfarë do të ndodhë pasi sistemi të mund riorganizohet dhe rimodelohet?

nga McKinsey¹

Raporti i nëntorit 2018

Një dhjetëvjeçar pas krizës së fundit financiare që shkundi botën mbarë, industria bankare globale dhe rregullatorët financiarë kanë punuar në sinkron për ta larguar sistemin financiar nga buza e greminës dhe kaosit drejt një terreni solid e me të sigurt. Në terma numerikë, raporti global i kapitalit bazë të nivelit të parë (Tier 1) - një tregues ky i sigurisë së sistemit bankar - u rrit nga 9.8 për qind në 2007-ën në 13.2 për qind në vitin 2017. Edhe tregues të tjerë të rrezikut u përmirësuan në vijim; për shembull, raporti i kapitalit të qëndrueshëm me aktivet e qëndrueshme u rrit nga 4.6 për qind në 2010-ën në 6.2 për qind në vitin 2017.

Ecuria ka qenë e qëndrueshme, veçanërisht gjatë pesë viteve të fundit, kur këto tregues të mësipërm merren në konsideratë (Figura 1), por, gjithsesi, ajo nuk ka qenë mbresëlënëse. Kthimi nga kapitali (ROE) në rrafsh global për industrinë bankare u luhet midis intervalit 8 dhe 9 për qind, që nga viti 2012 (Figura 2). Kapitalizimi i industrisë bankare në rrafsh global u rrit nga 5.8 trilion dollarë në vitin 2010 në 8.5 trilion dollarë në vitin 2017.

Një dhjetëvjeçar pas krizës, këto arritje flasin për zhdërvjelltësinë e industrisë bankare.

Por rritja e industrisë bankare vijon të mbetet e brishtë - të




Figura 1



Figura 2

¹ Ky artikull u botua fillimisht nga McKinsey & Company, www.mckinsey.com. Copyright (c) 2019. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ribotohet me leje.

ardhurat e industrisë u rritën me 2 përqind në vit, gjatë pesë viteve të fundit, dukshëm më poshtë se rritja vjetore historike e bankingut, prej 5-6 përqind.

Krahasuar me industritë e tjera, ROE e sektorit bankar pozicionohet diku te rezultatet mesatare. Sidoqoftë, nga këndvështrimi i një investuesi, ekziston një hendek i madh në vlerësim. Vlerësimet bankare janë tregtuar me zbritje (discount) ndaj jo-bankave që nga kriza financiare 2008-09. Në vitin 2015, kjo zbritje arriti në 53 përqind; në vitin 2017, pavarësisht ecurisë së mirë të sektorit bankar, kjo vlerë u përmirësua pak, në 45 përqind (Figura 3).

Çfarë dinë, apo supozohet se dinë investuesit, lidhur me perspektivën e industrisë bankare? Pjesërisht, ky vlerësim i ulët për industrinë bankare vjen nga shqetësimet e investitorit lidhur me aftësinë e bankave për të dalë nga rrethi vicioz i ecurisë së qëndrueshme, por jo të kënaqshme.

Mungesa e rritjes, si dhe rritja e huave me probleme, në disa tregje, mund të ulin pritshmëritë për to. Megjithatë, nga këndvështrimi ynë, mungesa e besimit të investitorit në të ardhmen e bankingut lidhet pjesërisht me pasigurinë nëse bankat mund të ruajnë rolin e tyre historik si udhëheqëse të sistemit të ndërmjetësimit financiar. Sipas vlerësimeve tona, ky sistem i ndërmjetësimit financiar ruan, transferon, jep hua, investon dhe menaxhon rrezik për fonde në një sasi mbi 260 trilionë dollarë (Figura 4).




Figura 3




Figura 4

Totali i të ardhurave që lidhet me ndërmjetësimin - shumica e të cilave ofrohet nga bankat - ishte afërsisht 5 trilionë dollarë në vitin 2017, ose afërsisht 190 pikë bazë. (Vihet re se deri në vitin 2011, mesatarja ishte rreth 220 pikë bazë.)

Pozicioni i bankave në këtë sistem është tashmë i kërcënuar. Veprimi i dyfishtë i inovacionit teknologjik (dhe i të dhënave), si dhe ndryshimet në mjedisin rregullator dhe një mjedis sociopolitik gjithnjë e më i zgjeruar, po hapin mundësi dhe shtigje të reja mëdha brenda sistemit të ndërmjetësimit financiar për pjesëmarrës të rinj, përfshirë këtu institucionet e tjera financiare të mëdha, ofruesit e financave të specializuara dhe firmat e teknologjisë. Një hapje e tillë e sistemit nuk ka as ndikim të njëanshëm dhe as nënkupton pasoja katastrofike për bankat.

Ku do na çojnë të tilla ndryshime? Ne mendojmë se sistemi kompleks dhe i ndërlidhur i ndërmjetësimit financiar do të riorganizohet, nga trysnia e teknologjisë dhe rregullimit, në një model më të thjeshtë që ka tre shtresa

(Figura 5). Ashtu sikurse uji gjen gjithmonë rrugën më të shkurtër drejt destinacionit përfundimtar, edhe fondet në rrafsh global do të rrjedhin përmes asaj shtrese ndërmjetësimi që i përshtatet më së miri qëllimit të tyre.

Shtresa e parë përbëhet nga transaksionet e përditshme tregtare (për shembull: depozitat, pagesat dhe huat konsumatore). Ndërmjetësimi këtu do të jetë thuajse i padukshëm dhe përfundimisht pjesë integrale e jetës digjitale të përditshme të klientëve. Shtresa e dytë dhe e tretë do të varen nga efekti i “shtangës” që shkakton teknologjia dhe të dhënat, të cilat nga njëra anë, mundësojnë një ndërveprim më efikas mes njerëzve dhe, nga ana tjetër, ofrojnë automatizim të plotë. Shtresa e dytë do të përfshijë gjithashtu edhe produkte e shërbime në të cilat marrëdhëniet dhe njohjet mes palëve bëjnë diferencën e madhe (për shembull: shkrirjet & bashkimet, strukturimi i produkteve derivate, menaxhimi i pasurisë, huat për korporatat). Udhëheqësit e tregut këtu do të përdorin në mënyrë të ndjeshme inteligjencën artificiale, por duke mos zëvendësuar plotësisht ndërveprimin njerëzor. Shtresa e tretë përfshin kryesisht transaksione “business-to-business”, si: shitjet dhe tregtimi masiv në tregje të letrave me vlerë, pjesët e standardizuara të menaxhimit të pasurisë dhe një pjesë e procesit të origjinimit. Në këtë shtresë, ndërmjetësimi institucional do të ishte shumë i automatizuar dhe do të sigurohej nga një infrastrukturë efikase teknologjike me kosto të ulët.

Ky sistem ndërmjetësimi financiar i përqendruar mund të duket paksa si vizion i largët, por ekzistojnë shembuj paralelë të ndryshimeve të rëndësishme




Figura 5

strukture në industri të ndryshme nga ajo bankare. Si shembull mund të silllet ndikimi i platformave “online” të rezervimit të biletave dhe të shërbimit të përdorimit të përbashkët, si Airbnb për agjencitë e udhëtimit dhe hotelet, ose rasti i “sfiduesve teknologjikë”, si Netflix, në fushën e shpërndarjes së filmit.

Theksojmë se këndvështrimi ynë për një sistem të ristrukturuar të ndërmjetësimi financiar është nga perspektiva e “personave të brendshëm”: ne nuk besojmë që klientët ose konsumatorët do t’i kushtojnë vëmendje të theksuar këtyre ndryshimeve strukturore thelbësore. Sigurisht që pyetja problematike këtu është ajo se çfarë nënkuptojnë këto ndryshime për bankat. Mendimi i McKinsey-t është se për bankat hapen katër opsione strategjike në këtë sistem të rimodeluar:

- orkestrues novator i ekosistemit të integruar,

- “prodhues” me kosto të ulët,
- bankë e përqendruar në segmente specifike të biznesit,
- bankë tradicionale, por plotësisht e optimizuar dhe e digjitalizuar.

Patjetër që shtegu i duhur për çdo bankë do të varet nga burimet aktuale të avantazhit konkurrues dhe nga fakti se cila nga shtresat përputhet me profilin e saj – ose me profilin sipas të cilit ajo synon të formatojë veprimtarinë e saj në të ardhmen. Ne besojmë se përfitimet nga kjo do të jenë joproportionale për ato firma që e kanë të qartë avantazhin e tyre konkurrues e që më pas hartojnë dhe venë në zbatim zgjedhje strategjike të mirëmenduara. Rezultati do të jetë një sektor financiar më efikas dhe krijon vlerë për klientët dhe shoqërinë në përgjithësi. Kjo është një e ardhme që duhet të energjizojë çdo drejtues bankar vizionar.

Banka Evropiane e Investimeve dhe financat e qëndrueshme

"Qëndrueshmëria në gjithçka që bëjmë - ky është objektivi ynë kur financojmë projekte në inovacion dhe mjeshteri, infrastrukturë, ndërmarrje të vogla dhe të mesme, mjedis, veprime për mbrojtjen e klimës dhe kohezion rajonal. BEI kryen analiza të thelluara, për të siguruar që projektet të përmbushin kriteret mjedisore dhe sociale dhe që të ofrojnë përfitimet afatgjata ekonomike të dëshiruara. Fondet e grumbulluara në tregjet e kapitaleve përmes obligacioneve të gjelbra dhe të qëndrueshme përdoren për projekte specifike që japin një kontribut të konsiderueshëm në zhvillimin e qëndrueshëm."



Ines HODDARI

Bankiere e lartë
BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE

Grupi i Bankës Evropiane të Investimeve është institucion i Bashkimit Evropian, i angazhuar në financimet afatgjata ("Banka e BE-së"). Ai ofron financim dhe asistencë teknike për të siguruar një rritje të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse përmes dy entiteteve të tjera, të lidhura me të: Bankës Evropiane të Investimeve (BEI) dhe Fondit Evropian të Investimeve (EIF)³. Në vitin 2018, Grupi i BEI-t ofroi 64.2 miliardë euro financime, nga të cilat 13.8 miliardë euro shkuan për inovacion dhe aftësim, 12.3 miliardë euro u kanalizuan në infrastrukturë, 23.3 miliardë euro për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) dhe 15.2 miliardë euro për mbështetjen ndaj mjedisit.

BEI është huamarrësi dhe huadhënësi më i madh shumëpalësh në botë. E themeluar në vitin 1958, ajo operon në vendet e BE-së dhe në më shumë se 130 vende të tjera. Ndërkohë që shumica e financimeve të BEI-t i dedikohet Shteteve Anëtare të BE-së, BEI vepron në mënyrë globale si një bankë zhvillimi shumëpalëshe. Nëpërmjet financimit të investimeve jashtë BE-së, BEI kontribuon në mënyrë aktive në objektivat e politikës së jashtme të BE-së. Faktikisht, BEI është instrumenti kryesor i BE-së për bankimant e zhvillimit, me një vëllim veprimtarie jashtë BE-së prej 7.8 miliardë euro në 2018-ën.

Vendet e Ballkanit Perëndimor përbëjnë përparësi kryesore për

veprimtarinë e huadhënies dhe që nga viti 2008, Grupi i BEI-t ka financuar mbi 8 miliardë euro projekte në këtë rajon. Kjo pasqyron angazhimin tonë për të mbështetur ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës bazë, si dhe ndihmën shumëdimensionale për sektorin privat, duke katalizuar investimet e huaja të drejtpërdrejta në projekte madhore investimesh (si p.sh.: gazsjellësi Trans Adriatik, veturat FIAT Auto Serbia, etj.), gjithashtu duke ofruar ndihmë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), nëpërmjet financimit të bankave evropiane në rajon, të cilat përforcojnë politikën e zgjerimit të BE. Për më tepër, në vitin 2016 BEI lançoi Nismën për Rimëkëmbje Ekonomike (IME), pas një kërkesë nga Këshilli i Evropës, për të trajtuar boshllëqet e infrastrukturës ekonomike dhe sociale, si dhe për të nxitur rritjen nëpërmjet sektorit privat dhe krijimin e vendeve të punës në rajon, me qëllim zgjidhjen e problemeve të shkaktuara nga migracioni dhe "rrjedhja e trurit". Për të përforcuar praninë e saj në nivel lokal, në vitin 2019 BEI hapi një zyrë në Shqipëri dhe Bosnjë - Hercegovinë, duke punuar ngushtë me ekipin operativ, me seli në Luksemburg. Këto zyra, së bashku me Zyrën Rajonale që punon aktivisht në Beograd, portretizojnë më së miri praninë e BEI-t në Ballkanin Perëndimor dhe angazhimin e saj për ta sjellë rajonin edhe më pranë Bashkimit Evropian.

Veprimi ndaj ndryshimeve klim-



Alessandro BRAGONZI

Përfaqësues për Shqipërinë, Kosovën² dhe Maqedoninë e Veriut
BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE

¹ Nga Raporti mbi Qëndrueshmërinë e Grupit të Bankës Evropiane për Investime - <https://www.eib.org/en/publications/sustainability-report-2018.htm>.

² Ky specifikim i referohet par paragjykim pozicionit të statusit dhe është në përputhje me UNSCR 1244 dhe opinionin e ICJ mbi deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

³ FEI është një subjekt i specializuar në financimet me rrezik (kapital aksionar dhe garanci) në përfitim të NVM-ve në të gjithë Evropën.

atike, si prioritet kyç për BE-në dhe BEI-n

Kjo është një shtyllë e rëndësishme e Planit të Veprimit të BE-së për Financat e Qëndrueshme dhe pozicionohet në qendër të kuadrit strategjik të BEI-t. Në veprimtaritë e saj, BEI ka luajtur dhe do të vijojë të luajë një rol thelbësor në arritjen e OZHQ-ve. Ndërkohë që huadhënia e BEI-t mbetet e përqendruar në objektivat e politikave publike, të tilla si: inovacioni, NVM-të dhe financimi i tyre, infrastruktura dhe mjedisi. Ne në BEI besojmë se mbështetja për veprimet lidhur me ndryshimet klimatike është në përputhje me arritjen e objektivave të tjera politike. Mbështetja e një tranzicioni drejt një ekonomie të qëndrueshme pa karbon, më të gjelbër e me aftësi për t'u rimëkëmbur shpejt, duhet të shkojë krah për krah. BEI ka qenë një pioniere e mbështetjes së financimit dhe gjetjes së burimeve të financimit, përsa i përket veprimeve ndaj ndryshimeve klimatike.

Nga krahu i financimit...

BEI ka zhvilluar një gamë të gjerë instrumentesh financiare, për të mbështetur investimet e lidhura me klimën nga promotorët e këtij projekti, nga sektori publik dhe ai privat. Kjo përfshin zvogëlimin e rrezikut për investues të caktuar, që në të kundërt nuk do të mbështesnin skemat e lidhura me klimën. Këto produkte inovative të financimit të projekteve të lidhura me klimën tërheqin më shumë financime nga sektori privat, për të luftuar kundër ndryshimeve klimatike dhe për të zbutur efektin e tyre. Për t'u siguruar që qëndrueshmëria është pjesë e pandarë e financimeve të BEI-t, këto të fundit nënkuptojnë tri gjëra: së pari, veprimtari të caktuara përjashtohen plotësisht nga financimi i BEI-t; së dyti, projektet dhe investimet u nënshtrohen parimeve dhe standardeve mjedisore e sociale të BEI-t;

dhe së treti, për të matur kostot dhe ndikimin financiar kryhet një vlerësim ekonomik, për të përcaktuar nëse shoqëria ka përfitime të mëdha nga investimi. BEI identifikon në mënyrë sistematike rreziqet klimatike për të gjitha projektet e investimeve, mat plotësisht elementët klimatikë të projekteve, si dhe rrit investimet në përshtatjen ndaj klimës. Në vitin 2018 BEI tejkaloi objektivin e saj prej 25% të veprimit ndaj ndryshimeve klimatike, për vitin e nëntë radhazi, duke ofruar më shumë se 16 miliardë euro për të luftuar ndryshimet klimatike. Kjo përbën mbi 29% të të gjithë financimit tonë. Tashmë po ecim mirë në rrugën e përmbushjes së angazhimit tonë për të mbështetur zbatimin e Marrëveshjes së Parisit, si dhe do të rrisim mbështetjen për veprimin ndaj ndryshimeve klimatike në vendet në zhvillim në 35% të huadhënies së të përgjithshme BEI-t, deri në vitin 2020.

...dhe në krahuin e sigurimit të fondeve...

BEI emtoi obligacionin e parë të gjelbër në vitin 2007. Që atëherë BEI vazhdoi të nxisë rritjen e qëndrueshme të këtij tregu, si emetuesi më i madh shumëpalësh, si Kryetare e Parimeve të Obligacionit të Gjelbër, koordinatore e Kornizës së Institucioneve Financiare Ndërkombëtare (IFN) për Harmonizimin e Raportimit të Ndikimit të Obligacioneve të Gjelbra, si dhe kontribuuese me ekspertizë në grupet e punës së Komisionit Evropian. Tregu i Obligacioneve të Gjelbra ka tërhequr vëmendje në rrafsh global. Grupi i Ekspertëve Teknikë të Komisionit Evropian (GET) për financimin e qëndrueshëm – me ndihmën e drejtpërdrejtë të ekspertëve të BEI-t në nën-grupet e GET-it, të ngarkuar me taksonominë dhe standardin⁴ e obligacionit të gjelbër – përcakton kritere të qarta për klasifikimin e veprimtarive ekonomike

dhe instrumenteve përkatëse të investimeve. Si konfirmim i angazhimit të BEI-t për OZHQ -të dhe Planit të Veprimit të BE-së për Financat e Qëndrueshme, në shtator 2018, BEI emtoi Obligacionin e parë për Vetëdije ndaj Qëndrueshmërisë (OVQ), prej 500 milionë eurosh. Fondet e mbledhura nëpërmjet OVQ-së do të jenë fillimisht të dedikuara për mbështetjen e projekteve të furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe mbrojtjes nga përmbajtjet.

BEI është e përgatitur të kontribuojë më shumë në veprimet ndaj ndryshimit të klimës

Financat e qëndrueshme nuk nënkuptojnë që BEI përqendrohet në sektorë të zgjedhur, që lidhen me veprimet ndaj ndryshimit të klimës. Gjithashtu, do të thotë se me veprimet tona synojmë të mbështesim veprimtari ekonomike që nxisin kalimin drejt një të ardhme me nivele të ulëta karboni dhe me klimë të përmirësuar. Përmes zbatimit të Strategjisë së BEI-t për klimën, kjo e fundit po i kalibron veprimtaritë e saj sipas parimeve dhe objektivave të Marrëveshjes së Parisit. Për këtë qëllim, ne po punojmë me Bankat Shumëpalëshe të Zhvillimit (BSHZH) për të krijuar një qasje të përbashkët dhe po marrim pjesë në përpjekjet e OECD-së në këtë drejtim.

Duhet pranuar se, duhet bërë më shumë për të trajtuar ndryshimet klimatike dhe se BEI nuk mund ta bëjë atë e vetme, madje as gjithë IFN-të së bashku. Për këtë arsye, BEI mirëpret të gjitha nismat e reja, që synojnë kanalizimin e më shumë fondeve publike për veprimet ndaj ndryshimit të klimës dhe veçanërisht ato që synojnë ta bëjnë këtë në një mënyrë që rrit ndikimin e fondeve në trajtimin e ndryshimeve klimatike, duke përfshirë rritjen e pjesëmarrjes së kapitalit privat.

⁴ https://ec.europa.eu/info/files/190618-sustainable-finance-teg-report-taxonomy_en
https://ec.europa.eu/info/files/190618-sustainable-finance-teg-report-overview-green-bond-standard_en



**Raiffeisen
BANK**

15
VJET RISI



DËRGOJINI PARA KONTAKTEVE TUAJA NËPËRMJET APLIKACIONIT KUIK

Transfertën mund ta kryeni te të gjitha kontaktet të cilat e kanë shkarkuar Aplikacionin KUIK në celular dhe kanë llogari pranë Raiffeisen Bank.

www.raiffeisen.al

Kriza ndërkombëtare e 2007/2008-ës pati një ndikim të vogël: Kriza greke dha goditje të fortë

Kriza ndërkombëtare (e huave hipotekare) e vitit 2008 i la bankat greke thuajse të paprekura, ndërkohë që u mjaftuan vetëm me pak ndërhyrje të kufizuara. Kriza greke e goditi sistemin bankar grek në të gjithë aspektet: në likuiditet, në cilësinë e aktiveve dhe përfundimisht në kapital, në përmasa të ndryshme.



Prof. Charoula APALAGAKI

Sekretare e Përgjithshme
SHOQATA E BANKAVE GREKE

Gjithkush është familjar me sfidat më të fundit të sektorit bankar grek, i cili, gjithsesi, po rimëkëmbet gradualisht dhe është gati të financojë ekonominë reale, në përputhje me kufizimet dhe udhëzimet aktuale, për të siguruar një rritje të qëndrueshme.

Një vështrim i shpejtë mbi ndryshimet në sistemin bankar grek

Para krizës, bankat greke ishin të mirë kapitalizuara (kapitali bazë i nivelit të parë ishte 10.6% në 2010-ën), kishin përdorim të moderuar të levës financiare (hua/aktive në 51%) dhe ishin relativisht likuide (L/D në 120%). Kriza ndërkombëtare (e huave hipotekare) e vitit 2008 i la bankat greke thuajse të paprekura, ndërkohë që u mjaftuan vetëm me pak ndërhyrje të kufizuara. Kriza

greke e goditi sistemin bankar grek në të gjithë aspektet: në likuiditet, në cilësinë e aktiveve dhe përfundimisht në kapital, në përmasa të ndryshme. Përfitueshmëria pësoi goditje serioze dhe prania ndërkombëtare u tkurr ndjeshëm. Recesioni i thellë dhe i zgjatur, shoqëruar me papunësi të lartë e që nxiti rritjen e huave me probleme dhe rënie të të ardhurave personale, çoi në tre ri-kapitalizime në shkallë të gjerë në rajon, me një vlerë prej 64 miliardë eurosh, si dhe në një rënie thelbësore të pjesës së pronësisë së aksionarëve. Paralelisht, sistemi bankar grek iu nënshtrua një konsolidimi në shkallë të gjerë, ku numri total i bankave tregtare (duke përfshirë bankat kooperativë) shkoi nga 19 në 8, nga të cilat vetëm 4 konsiderohen "të rëndësishme", ndërkohë që shumica e bankave të huaja u tërhoqën nga tregu. Sa i përket qeverisjes së korporatave, bankat greke iu përshtatën Direktivës Evropiane 2013/36/BE (CRD IV), e cila u transformua në ligjin grek 4261/2014; përbërja e Bordit të Drejtorëve ndryshoi ndjeshëm, e si rezultat: numri i bankave vendase u zvogëluar në mënyrë drastike nga 35 në vitin 2009 në 15 sot, nga të cilat 8 banka tregtare dhe 7 kooperativë; 4 banka konsiderohen të rëndësishme dhe, pas konsolidimit, kontrollojnë rreth 95% të aktiveve bankare: Banka Piraeus, Banka Kombëtare e Grekisë, Alpha Bank dhe Eurobank; bankat e huaja, ndonëse janë të

pranishme në Greqi, kanë një pjesë të parëndësishme tregu.

Rregullat e qeverisjes së korporatave u përcaktuan, në nivel evropian, nga Direktiva 2013/36/BE (CRD IV), e cila u shndërrua në ligjin grek 4261/2014. Sipas kërkesave të reja, institucionet greke të kreditit vijuan me ndryshime të rëndësishme, lidhur me përbërjen e bordeve të tyre, ndër të tjera:

- të gjithë anëtarët e bordeve të drejtorëve duhet të kenë së paku 10 vjet eksperiencë në nivel të lartë drejtues, në fushat e bankingut, auditimit, menaxhimit të rrezikut, ose menaxhimit të pasurive me probleme,
- anëtarët jo-ekzekutivë duhet që, përveç sa më lart, të kenë qenë së paku 3 vjet si anëtarë të bordit të një banke, të një shoqërie të sektorit financiar, ose të një institucioni financiar ndërkombëtar,
- anëtarët e pavarur jo-ekzekutivë – të paktën 3 – duhet të kenë njohuri të mjaftueshme dhe përvojë ndërkombëtare prej së paku 15 vjetësh në institucione bankare, nga të cilat së paku tre vite përvojë në një bord të një grupi bankar ndërkombëtar, që nuk vepron në tregun grek. Këta ekspertë nuk duhet të kenë lidhje, gjatë dhjetë viteve të fundit, me institucionet e kreditit që veprojnë në Greqi.

Bankat greke u angazhuan për zbatimin e planeve të ristrukturimit. Planet e ristrukturimit ishin angazhime ndaj Komisionit Evropian dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Konkurrencës, pas përdorimit të zgjeruar të ndihmës shtetërore. Angazhimet themelore konsistojnë në:

- Zvogëlimi i ekspozimit ndaj biznesit të tyre vendas jo-thelbësor,
- Zvogëlimi i ekspozimit ndaj bizneseve jo-greke:
 - dalje nga tregu i Evropës Juglindore dhe rajone të tjera,
 - kufizimi i mbështetjes me kapital për veprimtaritë e mbetura,
- Zvogëlimi i portofolit të investimeve,
- Zvogëlimi i shpenzimeve operative,
- Reduktimi i personelit dhe i rrjetit të degëve,
- Arritja e raportit Hua/Depozita në Greqi nën 115%,
- Reduktimi i kostos së depozitave.

Bankat greke tashmë po përmbushin angazhimet e marra, duke shitur shumë nga degët e tyre në rajonin e Evropës Juglindore, si dhe aktivet jo-thelbësore në Greqi (sigurime, hotele, veprimtaritë në pasuri të patundshme, etj.) Në total, bankat greke janë zotuar të reduktojnë:

- Shumën absolute të ekspozimeve me probleme, nga 106.9 miliardë euro në shtator 2016 në 64.6 miliardë euro deri në dhjetor 2019 (-40%),
- Shumën absolute të huave me probleme, nga 78.3 miliardë euro në shtator 2016 në 38.6 miliardë euro, deri në dhjetor 2019 (-51%).

Kurtë përmbushen këto objektiva, ato nuk do të kenë më efekt negativ në kapital.

Nxitësit kryesorë për arritjen e

këtyre objektivave janë: shlyerja e pagesave të prapambetura; fshirjet nga bilanci; likuidimi i kolateraleve dhe shitja e ekspozimeve me probleme. Sipas objektivave të rishikuara, pjesa më e madhe e zvogëlimit të ekspozimeve me probleme parashikohet të vijë nga segmenti i biznesit (61%), kundrejt 58% të paracaktuar nga objektivat e mëparshëm. Reduktimi i përgjithshëm i këtyre ekspozimeve, që nga 9 muhori i vitit 2019 deri në vitin 2019, arrin në 34.5 miliardë euro. Reduktimi i përgjithshëm i huave me probleme, për të njëjtën periudhë, arrin në 31.6 miliardë euro.

Nisma e HBA-së lidhur me Financat e Qëndrueshme

Sistemi bankar grek luan një rol kryesor për arritjen e një rritje të qëndrueshme, e cila është në përputhje me qëllimet e politikës sociale dhe mjedisore dhe plotësisht e harmonizuar me kuadrin rregullator ekzistues të BE-së dhe atë kombëtar. Në veçanti, bankat anëtare të HBA-së mbështesin në mënyrë aktive financat e qëndrueshme në procesin e huadhënies dhe investimeve (ndër të tjera), duke:

- promovuar produkte dhe shërbime të gjelbra /të qëndrueshme, në mënyrë që të zvogëlohet dëmi mjedisor dhe të inkurajohen firmat dhe ekonomitë familjare për të adoptuar praktikatat më të mira mjedisore dhe sociale;
- siguruar në vazhdimësi kurse trajnimi për personelin e tyre, përmes kryerjes së programeve të dedikuara, ose duke krijuar partneritete strategjike në nivel ndërkombëtar (p.sh.: me Nismën Financiare të OKB-së për Programin Mjedisor UNEP - FI), ose duke ndërmarrë nisimat e duhura në nivel kombëtar;
- pjesëmarrjen në indekse

të qëndrueshme ndërkombëtare (p.sh.: indeksi i qëndrueshmërisë Dow Jones, Sustainalytics, oekom research, Vigeo ratings, CDP, etj.); dhe

- zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe të BE-së (p.sh.: ISO 14001, EMAS) në mekanizmat dhe proceset e tyre të brendshme për analizimin dhe trajtimin e rreziqeve mjedisore dhe sociale, si dhe formulimin e udhëzimeve përkatëse të politikave të tyre.

Që nga viti 2010, HBA-ja ka krijuar një komision special ndërbankar, i cili monitoron në mënyrë të vazhdueshme të gjitha çështjet lidhur me financat e qëndrueshme dhe përgjegjshmërinë sociale, si dhe bashkëpunon me grupet e duhura të interesit, në rrafsh kombëtar, në këtë drejtim. Një nga nisimat më të fundit të këtij komiteti special është koordinimi i suksesshëm ndërbankar në drejtim të zbatimit (që nga viti 2018) i të ashtuquajturit **Sistemi i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (ESMS)** nga bankat anëtare të HBA-së. ESMS përbën një grup procedurash, formash aplikimi dhe veprimesh që janë bërë pjesë e procedurave në vijim të huadhënies nga bankat dhe merren parasysh gjatë vlerësimit të kërkesave për financim, sipas politikave të tyre të brendshme të huadhënies, standardeve të IFC-së dhe BERZhit, si dhe praktikave më të mira ndërkombëtare. Ajo konsiderohet si një metodologji për identifikimin dhe zbutjen e rreziqeve mjedisore dhe sociale, që mund të shkaktohen nga veprimtaritë e biznesit, si të bankës, ashtu dhe të ndërmarrjes (palës tjetër) në fjalë. Lidhur me ESMS, HBA-ja ka hartuar një fletëpalosje informuese të thjeshtë në përdorim, e cila i drejtohet klientëve korporatë të bankave anëtare të saj. Kjo broshurë informative është në dispozicion në

gjuhën greke dhe angleze, në faqen e internetit të HBA-së.

Në nëntor 2018, Nisma Financiare e OKB-së për Programin Mjedisor UNEP - FI nisi një konsultim publik në lidhje me të ashtuquajturat Parime për Banking të Përgjegjshëm (PBP - PRB), të cilat janë hartuar në bashkëpunim të ngushtë me 28 banka nga e gjithë bota (që së bashku përfaqësojnë më shumë se 17 trilionë USD në aktive). Këto parime i sigurojnë industrisë bankare një kornizë të vetme që integron qëndrueshmërinë në nivele strategjike, portofoli dhe transaksionesh, përgjatë gjithë fushave të biznesit dhe, gjithashtu, i vendos bankat në sintoni me qëllimet e shoqërisë, siç shprehen në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së dhe Marrëveshjen e Parisit për Klimën. Një nga bankat anëtare të HBA-së ishte ndër bankat themeluese, që morën pjesë aktive në hartimin e këtyre Parimeve. Banka të tjera anëtare të HBA-së janë në proces të shqyrtimit të mundësisë së nënshkrimit dhe zbatimit të këtyre Parimeve. Parimet janë të hapura për konsultime deri më 31 maj 2019 dhe do të finalizohen në tremujorin e tretë të 2019-ës.

Komisioni Evropian ka botuar, që nga marsi i 2018-ës, një Plan Veprimi gjithëpërfshirës për financimin e rritjes së qëndrueshme. Specifikisht, ky Plan Veprimi¹ synon lidhjen e mëtejshme të financave me nevojat specifike të BE-së dhe ekonomisë ndërkombëtare në të mirë të planetit dhe shoqërisë. Në maj të vitit

2018, Komisioni Evropian publikoi propozimet e para legjislative, në lidhje me Planin e saj të Veprimit, për financimin e rritjes së qëndrueshme, me qëllim që sektori financiar i BE-së të mund të lëvizë drejt një ekonomie më të gjelbër. Këto propozime përfshijnë:

- zhvillimin e një sistemi ("taksonomie") klasifikimi të unifikuar të BE-së, për projektet e investimeve të gjelbra /të qëndrueshme;²
- integrimin e faktorëve mjedisorë, socialë dhe qeverisës ("ESG") në procesin e vendimmarrjes së investitorëve institucionalë (siç janë institucionet e kreditit) dhe menaxherët e aktiveve;³ dhe
- krijimin e një kategorie të re të referencave, që përfshijnë referencat e ulëta të karbonit dhe referencat e ndikimit pozitiv të karbonit.⁴

Që nga mesi i qershorit 2019, propozimet legjislative që kanë të bëjnë me referencat dhe përfshirjen e faktorëve të ESG-së në procesin e vendimmarrjes së investitorëve institucionalë dhe menaxherëve të aktiveve, janë finalizuar dhe pritet të publikohen në Fletoren Zyrtare të BE-së, gjatë javëve /muajve të ardhshëm. Plani i veprimit i Komisionit Evropian bazohet në rekomandimet e politikave të një Grupi Ekspertësh të Nivelit të Lartë (HLEG) për Financa të Qëndrueshme, të cilat u prezantuan në fund të janarit 2018. HLEG u krijua nga Komisioni Evropian në dhjetor 2016. Plani i Veprimit të Komisioni

Evropian përcakton këto 3 objektiva kryesore:

- riorientimi i rrjedhave të kapitalit drejt investimeve të qëndrueshme, me qëllim arritjen e rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse;
- menaxhimi i rreziqeve financiare që rrjedhin nga ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore, degradimi i mjedisit dhe çështjet sociale; dhe
- nxitja e transparencës dhe vizionit afatgjatë në veprimtarinë financiare dhe ekonomike.

Nga ana tjetër, industria bankare evropiane duket e mbirregulluar, për shkak të krizës së vitit 2008, kështu që tani është koha e duhur për të eksploruar baraspeshën midis stabilitetit dhe financimit të ekonomisë reale.

Suksesi ekonomik i BE-së varet kryesisht nga rritja e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM), duke arritur potencialin e tyre. NVM-të kontribuojnë më shumë se gjysmën e vlerës së shtuar në sektorin jo-financiar dhe sigurojnë 80% të vendeve të reja të punës në Evropë, gjatë pesë viteve të fundit. NVM-të shpesh përballen me vështirësi të mëdha në sigurimin e financimit të nevojshëm, në mënyrë që të rriten dhe të përsosen. Për të rritur mbështetjen financiare ndaj NVM-ve, vendimmarrësit duhet të punojnë më tej në integrimin e aspekteve rregullatore (reduktimin e rrezikut) me ekonominë reale.

¹ COM [2018] 97 final.

² COM [2018] 353 final.

³ COM [2018] 354 final.

⁴ COM [2018] 355 final.

TË GJITHË PËR TOKËN




NDRYSHIMET KLIMATIKE



**KURSE
ENERGJINË**
PËRDOR LLAMPA EFIKASE



**IZOLO
AMBIENTET
E SHTEPISË**



**INVESTO
NË PANELE
DIELLORE**



RICIKLIMI I LETRËS



**KURSE
LETRËN**



**PËRDOR
ENË QELQI**



**BËHU
DIGJITAL**

LEXO, DËRGO DHE RUAJ DOKUMENTET
NË FORMË DIGJITALE

 **TIRANA BANK**



Empowered lives.
Resilient nations.

Tregu i huave me probleme dhe rritja e kreditimit në Republikën e Serbisë

Gjatë periudhës trevjeçare të zbatimit të Strategjisë u miratuan dhe u ndryshuan një numër i madh i akteve ligjore e nënligjore, u përmirësua kapaciteti institucional dhe u zbatuan shumë masa për shlyerjen dhe transferimin më të lehtë të huave të paarkëtueshme.



Vladimir VASIĆ
Sekretar i Përgjithshëm
SHOQATA E BANKAVE SERBE

Serbia përbën një shembull të shumë masave dhe veprimtarive të ndërmarra, për të ulur nivelin e huave me probleme gjatë gjashtë viteve të fundit, ku aspekti më i rëndësishëm është qasja sistemike në zgjidhjen e këtij problemi. Për më tepër, gjatë gjashtë viteve të fundit, Serbia shënoi rezultate të rëndësishme në drejtim të forcimit të stabilitetit makroekonomik dhe vendi u njoh si lider në drejtim të zgjidhjes së çështjes së huave me probleme, raporti i të cilave ra në 5.7%, në dhjetor të 2018-ës. Në këtë artikull paraqitet përvoja serbe në zgjidhjen e çështjes së huave me probleme të sektorit bankar dhe prioritetet kryesore për të ardhmen në zgjidhjen e çështjes së huave me probleme të sektorit shtetëror,

si dhe masat e planifikuara për sektorin real, me qëllim parandalimin e krijimit rishtas të huave me probleme. Këtu do të jepet edhe një tablo e zhvillimeve aktuale makroekonomike dhe treguesve kryesorë të sektorit bankar të Serbisë.

Zhvillimet Makroekonomike në Serbi

Viti 2018 u karakterizua nga prirje pozitive ekonomike, duke përfshirë rritjen e PBB-së me 4.4%, që është rritja më e lartë në dhjetë vjet. Në vitin 2019 rritja e pritshme e PBB-së është 3.5%. Inflacioni është mbajtur në nivele të ulëta (mesatarisht 2.0% në vitin 2018), deficit i llogarisë korente është përgjysmuar, primi i rrezikut të vendit është ulur ndjeshëm dhe klasifikimi i besueshmërisë është përmirësuar. Axhustimi i fortë fiskal mundësoi një rënie më të shpejtë se sa pritej të raportit të borxhit publik ndaj PBB-së, në rreth 50%. Investimet fikse u rritën me rreth 30%, ku pjesën kryesore e zunë investimet e sektorëve privatë dhe qeveritarë, të shoqëruar me një përgjysmim të papunësisë. Rritja e fortë e kursimeve në dinarë u vlerësua pozitivisht - kursimet u rritën rreth 25% në vitin 2018 dhe rritja po vijon edhe këtë vit. Huadhënia, e nxitur nga faktorët e kërkesës dhe ofertës, regjistroi një normë vjetore rritje prej 10.0%, në shkurt 2019 (9.9% në

fund të vitit 2018). Në të ardhmen pritet një rritje e mëtejshme e huadhënies, si rezultat i rritjes së qëndrueshme ekonomike, përmirësimit të kushteve në tregun e punës, efekteve lehtësuese të politikës së mëparshme monetare nga ana e BKS-së, normave të ulëta të interesit në eurozonë, konkurrencës ndërbankare dhe uljes së huave me probleme.

Sektori Bankar në Serbi

Sektori bankar përbëhet nga 28 banka (deri në fund të vitit 2018) dhe është i mirë kapitalizuar dhe shumë likuid. Niveli në rënie i huave me probleme, fakti që nuk ka përqendrim të disa llojeve të aktiveve në sektorin bankar si dhe shkalla e kënaqshme e konkurrencës dëshmon për stabilitet të sektorit bankar. Në fund të tremujorit të parë të 2019-ës, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 23.7%, shumë më lart se minimumi rregullator (i cili në 30 qershor 2017 ishte 8%). Raporti i huave me probleme ndaj totalit të huave të sektorit bankar ka rënë ndjeshëm dhe paraqet një prirje të dukshme rënëse, për shkak të zbatimit të Strategjisë së Zgjidhjes së Huave me Probleme, të miratuar në vitin 2015, si dhe veprimtarive të tjera rregullatore nga Banka Kombëtare e Serbisë. Raporti i huave me probleme arriti në 5.5% në fund të tremujorit të parë të vitit 2019, me një rënie prej

3.7%, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2018 ose 16.8%, në krahasim me gushtin 2015, kur u miratua Strategjia.

Përpyjekjet për zgjidhjen e çështjes së huave me probleme

Strategjia për trajtimin e Huave me Probleme/2015-2018

Në fund të vitit 2008, pjesa e huave me probleme ndaj totalit të huas në Serbi ishte 11.3% dhe në vitin 2009, kur kriza u përshkallëzua, stoku i huave me probleme u rrit me mbi 50%, në nivelin 15.7%, duke e rritur


së Çështjes së Huave me Probleme. Përveç kësaj, Qeveria dhe Banka Kombëtare e Serbisë miratuan plane veprimi, për të përmbushur objektivat strategjike.

Veprimtaritë e zhvilluara gjatë zbatimit të Strategjisë

Qëllimi kryesor i Strategjisë ishte:

- Parandalimi i akumulimit të huave me probleme, në nivelin që do të ndikonte negativisht në veprimtarinë huadhënëse dhe rritjen ekonomike, dhe

Figura 1: Raporti i Huave me Probleme bruto ndaj totalit të huave



Burimi: BKS

kështu raportin ndaj totalit të huas me 4.4%. Rritja e totalit të huave me probleme vazhdoi edhe në vitet që pasuan; raporti i tyre ndaj totalit të huas arriti një nivel historik prej 21.6% në vitin 2015, kur Strategjia ishte në përpunim e sipër.

Raporti i huave me probleme ishte më i larti në Serbi në vitin 2015, por ai ra në mënyrë të ndjeshme, në nivelin 5.7% gjatë zbatimit të Strategjisë, në fund të vitit 2018. Pas disa përpjekjeve për të zgjidhur këtë çështje komplekse nëpërmjet përdorimit të masave individuale, praktika vërtetoi që një zgjidhje e përhershme e çështjes së huave me probleme kërkon një qasje sistematike dhe përfshirje aktive të të gjitha institucioneve përkatëse. Në 13 gusht 2015, Qeveria miratoi Strategjinë Kombëtare të Zgjidhjes

- Përmirësimin e kushteve për zhvillimin e tregut të huave me probleme.


Gjatë periudhës trevjeçare të zbatimit të Strategjisë u miratuan dhe u ndryshuan një numër i madh i akteve ligjore e nënligjore, u përmirësua kapaciteti institucional dhe u zbatuan shumë masa për shlyerjen dhe transferimin më të lehtë të huave të paarkëtueshme. Një numër i madh i akteve ligjore u ndryshuan dhe u miratuan, veçanërisht në fushën e çmuarjes së vlerës së pasurive të paluajtshme, taksimit – me qëllim që të mundësohej një trajtim më i favorshëm, në rast të fshirjes së pretendimeve të paarkëtueshme, të ristrukturimit vullnetar financiar, i cili mundëson ristrukturimin e

borxheve, si të shoqërive ashtu edhe të sipërmarrësve. Gjatë periudhës së kaluar, BKS-ja kreu të gjitha veprimtaritë e paracaktuara nga Plani i Veprimit, që synonin kryesisht rritjen e kapaciteteve të bankave për të zgjidhur çështjen e huave me probleme. Përmirësime të rëndësishme u zbatuan në fusha të caktuara, si: standardet dhe praktikatat e kontabilitetit, si dhe të vlerësimit të kolateralit, kërkesave për dhënien e informacioneve nga bankat, lidhur me kolateralin, ekspozimeve të mëdha dhe njohjen e shpenzimit të interesit të huave me probleme. Në gusht të vitit 2017, BKS-ja miratoi Vendimin për fshirjen e detyrueshme të pretendimeve të arkëtueshme që ishin plotësisht të zhvlerësuar dhe për nxjerrjen e tyre jashtë bilancit të bankave.

Këtu është e rëndësishme të përmendet gjithashtu dhe angazhimi i BKS-së para zbatimit të Strategjisë, lidhur me çështjen e uljes së huave e probleme. Në vitin 2015, BKS-ja kreu një studim të veçantë diagnostikues mbi cilësinë e aktiveve të bankave, rezultatet e të cilave siguruan bazën për përmirësimin e akteve rregullatore dhe mbikëqyrëse (në fushën e SNRF-ve) duke u kthyer në një ndihmesë të madhe, kur u përcaktuan hapat praktikë në Planin e Veprimit të Strategjisë. Disa faktorë kontribuan në një ulje të ndjeshme të nivelit të huave me probleme gjatë periudhës së mëparshme trevjeçare: fshirja e huave me probleme, cedimi ose shitja, shlyerja dhe ripagesa e tyre, e në një masë më të vogël, ristrukturimi i huave me probleme.

Shembulli i mësipërm paraqet rëndësinë që kanë faktorët individualë, që çuan në uljen e nivelit huave me probleme. Një tregues i rëndësishëm i suksesit të Strategjisë, në segmentin e

Struktura e zvogëlimit të huave me probleme, në milionë EUR



zhvillimit të tregut të huave me probleme në Serbi është gjithashtu dhe shuma e përgjithshme e huave të shitura, brenda dhe jashtë bilancit, ndaj palëve jashtë dhe brenda sektorit bankar, të cilat arritën në 1,651 milionë euro, gjatë periudhës trevjeçare. Nga kjo shumë, rreth 81% e huave iu shitën personave jashtë sektorit bankar (1,331 milionë euro).

Hapat e ardhshëm (Programi për Huat me Probleme/2018-2020)

Zbatimi i masave të përcaktuara nga Strategjia, prodhoi rezultate të rëndësishme. Niveli i huave me probleme u ul ndjeshëm, pas miratimit të Strategjisë. Pas më shumë se tre vjetësh, që nga miratimi i Strategjisë, niveli i huave me probleme u ul në shtator 2018, në nivelin më të ulët që nga viti 2008, kur filloi të matet ky tregues cilësor i portofolit të huave bankare. Megjithatë, përtej zbatimit të suksesshëm të Strategjisë, është e nevojshme të ndërmerren edhe veprimtari të tjera, në mënyrë që të trajtohen dhe zgjidhen edhe çështjet e mbetura, si dhe të sigurohet qëndrueshmëria e rezultateve të arritura.

Qëllimi i Programit dhe Planit të Veprimit për Zgjidhjen e Çështjes së Huave me Probleme për periudhën 2018-2020 konsiston në heqjen e pengesave të identifikuara në sistem, të cilat pengojnë

zgjidhjen në kohë të huave me probleme dhe krijimin e sistemit që do të parandalojë akumulimin e mëtejshëm të këtyre huave dhe shfaqjen e efekteve negative në veprimtarinë e huadhënies, duke rrezikuar rritjen ekonomike. Me qëllim që të arrihet qëllimi bazë, janë identifikuar disa fusha vendimtare dhe brenda tyre është e nevojshme të përmirësohet: (1) kuadri rregullator, (2) ngritja e kapaciteteve dhe/ose (3) zbatimi i rregulloreve, lidhur me:

- zgjidhjen e çështjes së huave me probleme të bankave në proces falimentimi, si dhe të pretendimeve në emër dhe për llogari të shtetit,
- përmirësimin e kuadrit të falimentimit (krijimi i portalit në internet për ankandet online të aktiveve të ofruara nga procesi i falimentimit, përmirësimi i profesionit të administratorëve të falimentimit, përmes

trajnimeve, përmirësimi i funksionimit të gjykatave të falimentit. Rregullorja e falimentimit të sipërmarrësve)

- veprimtaritë që synojnë parandalimin e huave me probleme (kryerja e një studimi mbi shkallën e borxheve të korporatave dhe parandalimi i huave me probleme në sektorin real, zhvillimi i instrumenteve me qëllim parandalimin e shtrëngesës financiare dhe një fushatë informimi përkatëse, përmirësimi i kuadrit ligjor që lidhet me Ligjin për Afatet e Shlyerjes së Detyrimeve në Transaksionet Tregtare, thellimi i kuadrit ligjor që rregullon vlerësimin e pasurive të paluajtshme).

Përfundim

Veprimtaritë e kryera gjatë periudhës së mëparshme e kanë fuqizuar sistemin, duke parandaluar krijimin rishtas të huave me probleme, ku bankat janë inkurajuar të menaxhojnë më mirë rrezikun e besueshmërisë, duke i pastruar më tej bilancet e tyre, në vend që të shtyjnë zgjidhjen e çështjes së huave me probleme. E gjithë kjo ka rezultuar në krijimin e një mjedisi dhe hapësire të përshtatshme për një huadhënie të re, pra për rritjen e mëtejshme të huadhënies dhe veprimtarisë ekonomike në Republikën e Serbisë.



Kredia Konsumatore
Ekspres

 **otpbank**



3%
PA KOLATERAL

...diçka ju mungon!

Përmbusheni me Banka OTP Albania

Normë fikse interesi duke filluar nga 3% në Lekë*

Aprovim i shpejtë - Pa kolateral

Na kontaktoni në: www.otpbank.al • 0800 48 48 (pa pagesë) / +355 68 40 12 121 / +355 69 40 12 121

*për kohëzgjatje deri në 1 vit

OTP BANK Albania

Një bankë ambicioze për zhvillimin e tregut bankar shqiptar

Banka OTP Albania do të jetë një aktor mjaft aktiv në tregun bankar shqiptar. Synimi i bankës tonë është të rritemi më tej, si dhe të mbajmë një cilësi shumë të mirë shërbimi për klientët tanë.



Bledar SHELLA

Drejtor i Përgjithshëm
OTP BANK Albania

OTP Bank është tashmë realitet në tregun bankar shqiptar. Cila është OTP Bank?

OTP Grup është një aktor tepër i rëndësishëm në industrinë bankare në Hungari dhe në Evropën Qendrore dhe Lindore. E themeluar që prej vitit 1949, grupi është zhvilluar vazhdimisht, duke qenë sot një grup bankar ofrues i shërbimeve financiare universale.

OTP ka një rol dominues në tregun bankar, hungarez duke qenë banka më e madhe me mbi 30% pjesë të tregut. Që prej fillimit të viteve 2000, OTP Bank ka qenë aktive në zgjerimin e saj në rajon dhe ka përfunduar disa blerje të suksesshme. OTP Group është shndërruar në një lojtar kryesor në rajon, ku përveç Hungarisë, me hyrjen në Shqipëri, OTP Group aktualisht operon në 9 vende të tjera, nëpërmjet filialeve të saj në: Bullgari (DSK Bank, Expressbank), Kroaci (OTP Banka Hrvatska), Rumani (OTP Bank Romania), Serbi (OTP Banka Srbija, Vojvodjanska Banka) Sllovaki

(OTP Banka Slovensko), Ukrainë (CJSC OTP Bank), Malin e Zi (Crnogorska Komercijalna Banka), Rusi (OAO OTP Bank) dhe së shpejti dhe në Slloveni e Moldavi.

Synimi i OTP Group është të jetë banka më e madhe në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore.

Pse OTP Bank zgjodhi të vijë në Shqipëri, në një kohë kur vërehet tërheqje e grupeve bankare nga rajoni i Ballkanit?

OTP Group e ka nisur zgjerimin e tij në vitin 2001 dhe synimi i tij është të jetë banka më e madhe në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore. Mund të themi që ky grup është zgjeruar me një qëndrueshmëri të lartë, duke rritur njëkohësisht edhe përfitueshmërinë e tij. OTP Group ka synuar të hyjë në tregun bankar shqiptar që në vitin 2003, një lëvizje që u arrit të realizohej tani, nëpërmjet blerjes së një banke tjetër evropiane dhe në një pozicion të favorshëm. Tregu shqiptar është një treg në zhvillim dhe i qëndrueshëm, nga pikëpamja makroekonomike, si dhe ka ende hapësirë për rritje dhe zhvillim, si në madhësinë e tregut ashtu edhe në aspektin e produkteve dhe shërbimeve bankare.

Si pjesë e një prej grupeve bankare më të mëdha në Evropën Qendrore, a mund të shpjegoni shkurtimisht strategjinë e biznesit për të zhvilluar veprimtarinë bankare në Shqipëri?

Pritshmëritë për sistemin bankar në 2019 janë pozitive. Mendoj se do të ketë një përmirësim të mëtejshëm në krahasim me vitin 2018. Rritja ekonomike është e kënaqshme, rreth 4%, huat me probleme kanë rënë

dhe likuiditeti dhe mjaftueshmëria e kapitalit është e lartë. Të gjitha këto krijojnë kushtet e përshtatshme për një rritje të veprimtarisë bankare.

Përsa i përket Bankës OTP Albania, pritshmëritë tona për vitin 2019, të konfirmuara dhe me rezultatet e tremujorit të parë, janë mjaft pozitive. Ne do të jemi shumë aktivë, duke rritur huadhënien, si për individët ashtu dhe për bizneset; do të hapim degë të reja dhe do të investojmë në produkte të reja. Cilësia e portofolit të huave është shumë e mirë. Unë dhe stafi kemi shumë besim që do të jetë një vit shumë pozitiv për Bankën.

Si e shihni ju pozicionimin e OTP Bank Albania në sektorin bankar shqiptar dhe në sistemin financiar, lidhur me produktet dhe shërbimet bankare?

Banka OTP Albania do të jetë një aktor mjaft aktiv në tregun bankar shqiptar. Synimi i bankës tonë është të rritemi më tej, si dhe të mbajmë një cilësi shumë të mirë shërbimi për klientët tanë. Zhvillimi i mëtejshëm i produkteve dhe shërbimeve bankare është një prej objektivave tanë kryesorë. Kjo arrihet duke ngritur një marrëdhënie afatgjatë me klientët dhe partnerët tanë. Gjithashtu, jemi duke punuar për hapjen e degëve të reja në Tiranë për t'ju ardhur sa më pranë bizneseve dhe për t'ju përgjigjur sa më mirë kërkesave të tyre. Të gjitha këto do të shoqërohen me rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj klientëve tanë nëpërmjet digjitalizimit të një sërë proceseve. Ne do të vazhdojmë të investojmë në zhvillimin e produkteve të reja, duke i vënë një theks të veçantë mundësive për digjitalizim.

Tirana Bank

Konsolidimi dhe rritja e mëtejshme, objektivat për 2019

Tirana Bank do të shfrytëzojë mundësitë e zhvillimit që paraqet tregu vendas, me një përjasje dinamike por edhe të kujdesshme, në drejtim të zgjerimit të portofolit të kreditimit të ekonomisë vendase, duke iu referuar në mënyrë të balancuar segmentit të individëve dhe të biznesit.



Dritan MUSTAFA

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
TIRANA BANK

Tashmë Tirana Bank ka aksionarë të rinj. Pse një lëvizje e tillë drejt bankingut, në një kohë shkrirjesh, bashkimesh dhe tërheqjesh, nga tregje të caktuara, të grupeve bankare ndërkombëtare?

Zhvillimi më i rëndësishëm gjatë periudhës 2018–2019 është prirja e konsolidimit të sistemit bankar dhe ndryshimet në pronësinë e disa bankave, e si rrjedhojë, ulja e numrit të operatorëve në treg. Ky proces transformimi ka qenë i pashmangshëm dhe tërësisht në linjë me prirjet në industrinë financiare globale. Si rezultat i krizës ekonomike, kryesisht përgjatë dhjetëvjeçarit aktual, shumë grupe bankare shfaqën nevojën për ndryshime strategjike, referuar modelit të tyre të biznesit, riformatimit të pranisë gjeografike, ndryshime në linjat specifike të veprimtarisë, etj. Kjo është në thelb

arsyeja pse përgjatë viteve të fundit, disa grupe bankare ndërkombëtare vendosën të shesin aksionet në filialet e tyre në Shqipëri dhe daljen nga tregu vendas.

Largimi i grupeve tradicionale bankare po shoqërohet me hyrjen në treg të aktorëve të rinj, që është tregues i nivelit të interesimit në sektorin bankar shqiptar, për shkak të potencialit për një penetrim më të lartë të klientela me shërbime dhe produkte bankare, në përputhje me prirjen e veprimtarisë në tregjet e zhvilluara. Gjithashtu, vlerësohet që grupet ekonomike vendase, apo



Strategjia jonë konsiston në rritjen e dinamikës së veprimtarisë, me objektivi kryesor rritjen e vëllimit dhe të shpejtësisë së huadhënies, por edhe nëpërmjet ofertave specifike të ndërtuara për segmente specifike të klientelës.



rajonale, po luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në strukturën dhe zhvillimin ekonomik të vendeve përkatëse, me objektivi për të vijuar investimet në sektorë dhe industri të ndryshme.

Grupi Balfin, që zotëron shumicën e aksioneve në Tirana Bank, ka një eksperiencë të konsoliduar dhe mjaft pozitive në drejtim të zgjerimit dhe të diversifikimit të investimeve në Shqipëri, e në rajon. Hyrja në sektorin

bankar konsiderohet një lëvizje e natyrshme, e shoqëruar me një vizion të qartë, për të vijuar mbështetjen për zhvillimin e ekonomisë vendase dhe rritjen e standardeve të shërbimit ndaj klientëve. Banka ka ruajtur identitetin e saj, si një institucion financiar vendas i rëndësishëm gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit, si dhe lidhjet me bazën tradicionale dhe të qëndrueshme të klientëve.

Cili do të jetë tipari dallues dhe çfarë ndryshimi mendoni se do të sjellë Tirana Bank në tregun bankar shqiptar?

Sektori bankar vendas ka karakteristika të qëndrueshme zhvillimi. Bankat vijojnë të zbatojnë me kujdes hapa në drejtim të optimizimit të pranisë dhe rimodelimit të veprimtarisë, në përputhje me prirjet në industrinë financiare globale, kryesisht në drejtim të një numri më të vogël degësh dhe rritje graduale të kanaleve alternative.

Tirana Bank ushtron një model biznesi universal, duke i shërbyer klientëve individualë, sikurse dhe klientëve me profil biznesi dhe atyre institucional. Banka ka një prani të mjaftueshme, për sa i përket rrjetit të degëve dhe shtrirjes gjeografike. Pavarësisht procesit të ndjekur për ndryshimin e strukturës aksionare, finalizuar në shkurt 2019, banka ka operuar normalisht në përputhje me objektivat strategjikë, në drejtim të ruajtjes së stabilitetit financiar, rritjes së marrëdhënieve dhe bazës së klientelës, rindërtimit të portofolit të aktiveve financiare, nëpërmjet një veprimtarie huadhënie të shëndoshë.

Gjithashtu, banka vijon të ruajë një pozicion të fortë të kapitalit dhe të likuiditetit, duke qenë një nga institucionet financiare më të sigurta në treg. Kjo përbën një mundësi për të qenë pikë reference për mbështetjen e nevojave të individëve apo bizneseve, duke konsideruar edhe sinergjitë e bashkëpunimit me rrjetin e gjerë të klientëve dhe bashkëpunëtorëve. Strategjia jonë konsiston në rritjen e dinamikës së veprimtarisë, me objektiv kryesor rritjen e vëllimit dhe të shpejtësisë së huadhënies, por edhe nëpërmjet ofertave specifike të ndërtuara për segmente specifike të klientelës.

Investimet tona në fushën e teknologjisë së informacionit dhe të kanaleve alternative të shitjes, përbëjnë një angazhim të qartë, në drejtim të inovacionit, modernizimit të infrastrukturës dhe proceseve, si dhe të përmirësimit të cilësisë së

shërbimit ndaj klientit, duke synuar edhe optimizim të burimeve të bankës.

Cilat mendoni se do të jenë sfidat madhore për Tirana Bank gjatë viteve në vijim, brenda sektorit bankar shqiptar?

Prirja e konsolidimit të mëtejshëm në sistemin bankar do të vijojë edhe përgjatë një periudhe afatmesme, për të arritur në një numër më të arsyeshëm të numrit të bankave referuar përmasave relativisht të vogla të tregut shqiptar. Kjo përbën një sfidë strategjike, e cila do të përcaktojë edhe mundësitë dhe masën e rritjes organike të sistemit në përgjithësi dhe të bankave individuale në veçanti. Zhvillimet me ritme të shpejta në fushën e teknologjisë së informacionit do të paraqesin sfida të veçanta, ndaj kjo çështje kërkon vëmendje të vazhdueshme nga të

gjithë operatorët bankarë, për të parandaluar rreziqet operacionale me natyrë teknologjike.

Cili është objektivi strategjik i Tirana Bank në një treg bankar vendas tashmë më të konsoliduar?

Në synojmë dhe vlerësojmë që Tirana Bank do të vijojë të mbetet një bankë me peshë sistemike dhe një partner afatgjatë dhe i qëndrueshëm për klientët e saj. Tirana Bank do të shfrytëzojë mundësitë e zhvillimit që paraqet tregu vendas, me një përjasje dinamike por edhe të kujdesshme, në drejtim të zgjerimit të portofolit të kreditimit të ekonomisë vendase, duke iu referuar në mënyrë të balancuar segmentit të individëve dhe të biznesit. Gjithashtu, ne do të vijojmë të investojmë në drejtim të modernizimit të infrastrukturës operacionale, në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira bankare.



Tri strategji efektive për të luftuar ekonominë informale

Meqenëse ekonomia informale ka ndikim negativ në shumë aspekte të shoqërisë, zvogëlimi i madhësisë së saj mund të përmirësojë jetën e njerëzve në mbarë botën, si dhe të sjellë një sërë përfitimesh për punonjësit, bizneset dhe qeveritë.



Vladimir DJORDJEVIC

Drejtor i Përgjithshëm
SEE, VISA

Më shumë se 23 për qind e ekonomisë botërore funksionon jashtë kontrollit të qeverive, duke lënë çdo vit më shumë se 10,700 miliardë USD veprimtari ekonomike të pa raportuar. Këto janë gjetjet e një studimi të parë të këtij lloji, i porositur nga VISA dhe i kryer nga A.T.Kearney. Faktikisht, ekonomia informale është e pranishme në shumë aspekte të jetës sonë të përditshme. Pavarësisht se madhësia dhe vizibiliteti i saj ndryshon, çdo vend dhe çdo industri ka një nivel të caktuar të veprimtarisë informale, ose jashtë transaksioneve zyrtare dhe të gjithë kanë një gjë të përbashkët: shumica e transaksioneve kryhen

me para' në dorë. Zhvendosja e këtyre transaksioneve drejt ekonomisë formale mund të sjellë një sërë përfitimesh, përfshirë këtu më pak varfëri, siguri më të madhe në punë dhe qasje më të madhe në përfitimet sociale, si dhe të ardhura tatimore shtesë, për të nxitur zhvillimin e infrastrukturës, arsimit dhe kujdesit shëndetësor. Siç tregon dhe studimi, rritja e pagesave digjitale me 10 për qind në vit për pesë vjet rresht mund të rrisë PBB-në globale deri në 1,500 miliardë USD, deri në vitin 2021.

Faktorët që nxisin individët dhe bizneset drejt ekonomisë informale ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin dhe ndikimi i tyre nuk është i njëjtë. Kur ekonomitë kalojnë një krizë ose stanjacion ekonomik, individët dhe bizneset përpiqen të kompensojnë humbjen e të ardhurave nga ekonomia formale, duke iu drejtuar ekonomisë informale. Për shembull, në vitet pas krizës globale ekonomike dhe financiare, papunësia zyrtare në rrafsh global u rrit nga 6.8 për qind në vitin 2008 në 8.5 për qind në vitin 2013, duke u shoqëruar me një rritje paralele të ekonomisë informale. Ndërkohë që rritja e papunësisë mesatare në rrafsh global mund të mos duket si shumë e madhe, shumë vende përjetuan një papunësi të lartë.

Edhe disa biznese serioze veprojnë në ekonominë joformale, për shkak të një sërë pengesash

burokratike dhe rregullash administrative. Por edhe në rastet kur rreziqet për të vepruar në ekonominë joformale janë më të mëdha se sa përfitimet e perceptuara, mund të mos gjenden pengesa të besueshme në këtë drejtim, për shkak të faktorëve mbizotërues socialë dhe jo-ekonomikë.

Meqenëse ekonomia informale ka një ndikim negativ në shumë aspekte të një vendi dhe shoqërisë së tij, neutralizimi i saj mund të përmirësojë jetën e qytetarëve dhe të krijojë përfitime për qeveritë dhe bizneset, që veprojnë nën juridiksionin e tyre. Konsumatorët dhe individët, që përdorin mallra dhe shërbime të ekonomisë informale, janë gjithashtu përballë një rreziku më të madh, për shkak të mungesës së respektimit të standardeve të cilësisë dhe sigurisë. Bizneset përballen gjithashtu me një sërë ndikimesh negative, përfshirë këtu edhe konkurrencën e pandershme. Për qeveritë, efekti më i dukshëm është te të ardhurat më të ulëta tatimore. Punësimi informal redukton kontributet e punonjësve të bizneseve, si dhe tatimet mbi të ardhurat personale. Nën-raportimi i shitjeve zvogëlon sasinë e tatimit mbi vlerën e shtuar ose të tatimit mbi shitjen, tarifat dhe akcizat - që nënkupton se që qeveritë kanë më pak fonde për të investuar në programe të ndryshme, duke përfshirë

infrastrukturën, shëndetësinë, arsimin dhe sigurinë, të cilat u shërbejnë të gjithë qytetarëve.

Vende të ndryshme përpiqen të kufizojnë ekonominë informale dhe të inkurajojnë përdorimin e pagesave digjitale në mënyra të ndryshme. Meqenëse ekonomia informale mbështetet në përdorimin e parasë së gatshme dhe lulëzon kur transaksionet nuk mund të identifikohen nga autoritetet përkatëse, ajo ndeshet me pengesa të mëdha në botën digjitale. Strategjitë e pagesave digjitale luajnë tashmë një rol më të madh se më parë, kur mbizotëronte një qasje shtrënguese.

Dekurajimi i përdorimit të parasë së gatshme përfshin reduktimin e përparësive të perceptuara të pagesës me to, si dhe ndryshimin e zakoneve dhe traditave të tjera që mundësojnë përdorimin e saj në vijim. Ka shumë mënyra për të zvogëluar sasinë e parasë së gatshme në qarkullim, duke përfshirë komisione më të larta për tërheqje nga ATM-të ose degët e bankave, kufij ditorë, ose javorë, për tërheqjen e parave të gatshme dhe qasje më e lehtë në depozita pa kosto, ose me kosto të ulët.

Zgjerimi dhe modernizimi i infrastrukturës për pranimin e kartave dhe pagesave pa kontakt, është një tjetër qasje për rritjen e përdorimit të pagesave digjitale. Zgjedhja e konsumatorëve për përdorimin e parave të gatshme, ose të pagesave digjitale ndikohet nga infrastruktura e pagesave dhe gatishmëria e tregtarëve për të pranuar pagesa digjitale.

Një qasje e tretë është **inkurajimi i përdorimit të pagesave digjitale.** Shumica e masave bien në këtë kategori. Qeveria, si paguesi dhe përfituesi më i madh në shumicën e vendeve,

ka një mundësi të madhe për të modeluar sjelljet e pagesave nga bizneset dhe individët - për shembull, duke mundësuar transaksione digjitale për të gjitha problematikat publike, ose duke ofruar infrastrukturë për pagesa digjitale në zyrat e saj.



Roli i pagesave digjitale do të rritet pashmangshmërisht - duke sjellë një ndikim pozitiv jo nëpërmjet shtrëngimit, por nëpërmjet lehtësive dhe komoditetit. Megjithatë, asnjë grup i zakonshëm politikash nuk mund të zvogëlojë madhësinë e një ekonomie informale, sikundër nuk ekziston ndonjë recetë universale që mund të krijojë një politikë efektive të pagesave digjitale. Qasja ideale ndryshon nga njëri vend në tjetrin.



Nxitësit për përdorimin e pagesave me karta kanë demonstruar se janë një mënyrë efektive për të rritur përdorimin e pagesave digjitale, veçanërisht kur lidhen me taksa më të ulëta.

Kartat e zgjuara kanë revolucionarizuar sektorin e transportit duke konvertuar në mënyrë të qëndrueshme pagesat në vlerë të vogël në transaksione digjitale. Transporti në Londër ka shënuar sukses me karta e zgjuara universale (*open loop*), ku më shumë se 1 miliard udhëtime janë kryer me pagesa pa kontakt, që nga korriku i 2017-ës.

Pavarësisht se është thelbësisht e padukshme, ekonomia informale dëmton

shoqërinë në mënyra të ndryshme, që shkojnë përtej pasojave financiare të PBB-së dhe të ardhurave nga tatimet - që nga kushtet e pafavorshme të punës dhe nga mungesa e standardeve të sigurisë, deri te konkurrenca e pandershme dhe nivelet e larta të varfërisë dhe pabarazisë. Meqenëse ajo ka ndikim negativ në shumë aspekte të shoqërisë, zvogëlimi i madhësisë së ekonomisë informale mund të përmirësojë jetën e njerëzve në mbarë botën, si dhe të sjellë një sërë përfitimesh për punonjësit, bizneset dhe qeveritë.

Roli i pagesave digjitale do të rritet pashmangshmërisht - duke sjellë një ndikim pozitiv jo nëpërmjet shtrëngimit, por nëpërmjet lehtësive dhe komoditetit. Megjithatë, asnjë grup i zakonshëm politikash nuk mund të zvogëlojë madhësinë e një ekonomie informale, sikundër nuk ekziston ndonjë recetë universale që mund të krijojë një politikë efektive të pagesave digjitale. Qasja ideale ndryshon nga njëri vend në tjetrin.

Të gjithë grupet e interesit - autoritetet publike, ofruesit e shërbimeve të pagesave, institucionet financiare, operatorët celularë, tregtarët dhe bizneset - duhet të luajnë role të ndryshme në tregjet e tyre, si dhe në përparimin e pagesave digjitale. Autoritetet publike kanë një rol themelor dhe të shumëfishtë. Përveç sigurimit të një kuadri ligjor dhe rregullator, ato mund të veprojnë si "bashkues" mes grupeve të interesit - duke moderuar dialogun lidhur me përpilimin e hartës së rrugës, caktimin e prioritetëve, udhëheqjen e veprimeve kolektive dhe sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies për rezultatet përkatëse.

BAZEL III dhe ndikimi i tij në sektorin bankar

Ajo që ka më shumë të ngjarë të ndodhë është që, si rregullatorët edhe pjesëmarrësit e tregut financiar, janë të gatshëm të pranojnë një rritje ekonomike pak më të ngadaltë, nëse kjo do përkthehet në një stabilitet më të madh dhe në një rënie të mundësisë për përsëritjen e ngjarjeve të viteve 2008-2009.



Rajmond PAVACI

Menaxher, Divizioni i Menaxhimit të Riskut
ALPHA BANK ALBANIA

Bazel III shënon hyrjen e sistemit bankar në një epokë të re, ku gjithkush i përfshirë në të gjitha nivelet e në të gjitha rolet, ka filluar të kuptojë se bankingu është tashmë më kompleks se kurrë dhe se problemet duhet të diagnostikohen përpara se të bëhen serioze.

Bazel III përbën një set të dakordësuar rregullash ndër-kombëtare bankare, të hartuara nga "Banka për Rregullime Ndërkombëtare" (BIS), për të promovuar stabilitetin në sistemin financiar ndërkombëtar. Rregullat e Bazel III janë të dizajnuara për të minimizuar dëmet në ekonomi nga ana e bankave që sipërmarrin rrezik të tepërt. Ai përbën një shtesë të Kornizës ekzistuese të

Bazel II, e cila synohet të bëhet më e fortë, duke u fokusuar në krahun e detyrimeve, d.m.th. në kapitalin dhe likuiditetin, në vijimësi të fokusit në krahun e aktiveve, që i dha Bazel II. Masat e sugjeruara nga Bazel III synojnë vendosjen e standardeve të reja të kapitalit dhe likuiditetit për të forcuar rregullimin, mbikëqyrjen dhe administrimin e rrezikut të të gjithë sektorit bankar dhe financiar. Bazel III do të rezultojë në një sistem më të sigurt financiar, por duke kufizuar ritmin e rritjes ekonomike në të ardhmen.

Kriza e huadhënies, që pasoi pas vitit 2008, rritja e borxheve të këqija, recesioni global, trysnia mbi nivelet e kapitalit të bankave dhe nevoja për rregulla dhe rregullore të reja, kombinuan parakushtet për një menaxhim bankar më sfidues se kurrë. Pas fillimit nga zbatimi, Bazel III pritet të japë ndikimin e tij në uljen e përfitueshmërisë së bankave në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, por pritet që, i kombinuar me masa të tjera, ai do të rrisë stabilitetin në sistemin financiar, i cili në kthim siguron nivele të qëndrueshme të rritjes ekonomike, në një perspektivë afatmesme dhe afatgjatë.

Siç ndodhi për më shumë se një dhjetëvjeçar, Banka e Shqipërisë si rregullatore e sektorit bankar në vend ka zbatuar kërkesat e Bazel II dhe i vuri në zbatim sipas karakteristikave dhe nevojave të tregut të brendshëm. Kjo vlen

gjithashtu edhe për **Rregulloren e re të miratuar nr.27/2019 "Për Raportin e Mbulimit të Likuiditetit"** më 28.03.2019, që hyn në fuqi në mars të vitit 2020. Kjo do të plotësojë më tej kuadrin e nevojshëm, pas **Rregullores nr.48/2013, "Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit"**, që hyri në fuqi në maj të vitit 2018, veçanërisht pasi u plotësua me **Udhëzimin nr.26/2017 "Për Procesin e Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit - ICAAP"**.

Kapitali (sipas kushteve të Bazel III) shërben si një amortizues për të absorbuar humbjet e papritura dhe për të financuar veprimtarinë në vijim të bankave, të cilave nga ana tjetër u kërkohet një sasi minimale kapitali, kështu që bankat duhet të mbajnë më shumë kapital kundrejt aktiveve të tyre, duke zvogëluar në këtë kuptim madhësinë e bilanceve dhe aftësinë e tyre për të përdorur më shumë efektet e levës (financiare). Rregullat e Bazel III përmbajnë disa ndryshime të rëndësishme lidhur me strukturat e kapitalit të bankave. Sasia minimale e kapitalit, si përqindje e aktiveve, sugjerohet të rritet dhe përtej saj, kërkohet edhe një tjetër shtesë mbrojtëse kapitali, duke e çuar kërkesën totale për kapital në një përqindje më të lartë (niveli i mëparshëm i Bazel II është rritur nga 2% në 4.5%, plus një shtesë mbrojtëse prej 2.5%, që nënkupton se niveli prej 7% është vendosur

tashmë si kërkesa minimale për kapital) dhe ka të ngjarë që, për shumë banka do të jetë një sfidë më vete mbajtja e një niveli pak më të lartë të kapitalit, për t'u përdorur si masë mbrojtëse. Më pas, nëse institucionet financiare perceptohen si më të sigurta, kostoja e kapitalit për bankat në fakt do të mund të ulet dhe bankat më të qëndrueshme mund të emetojnë borxh me një kosto më të ulët.

Marrëveshja u miratua nga anëtarët e Komitetit të Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare që para prillit 2013, kur ajo u rishikua tërësisht dhe kërkesat shtesë për zbatimin e saj filluan pas marsit 2018 dhe që pritet të hyjnë plotësisht në fuqi pas janarit 2022. Kërkesat e Bazel III erdhën si përgjigje ndaj mangësive në rregullimin financiar, që dolën në pah gjatë krizës financiare të viteve '2000 dhe synojnë të forcojnë kërkesat për kapital bankar, duke rritur likuiditetin e bankës dhe duke ulur levën financiare.

Sa i përket Likuiditetit, Bazel III kërkon dy raporte minimale likuiditeti: a. **Raporti i Mbulimit të Likuiditetit (LCR)**, i cili siguron që banka ka në dispozicion nivele të mjaftueshme të aktiveve likuide me cilësi të lartë, të mjaftueshme për një veprimtari një mujore nën një skenar shtrëngese të rëndë; dhe b. **Raporti i Financimit të Qëndrueshëm Neto (NSFR)**, i cili nxit fleksibilitetin në horizont afatgjatë, duke krijuar më shumë duke u bërë më shumë shtysë për institucionet financiare që të financojnë veprimtaritë e tyre me burime më të qëndrueshme financimi, mbi baza të vazhdueshme strukturore. Dobësitë e vërejtura në praktikën e administrimit të rrezikut e orientuan Komitetin e Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare (BCBS) që të

përfshinte, në përgjigje të krizës, një përforsim të rëndësishëm të kuadrit të saj për Rreziqet e Besueshmërisë së Palëve të Treta (CCR), për transaksionet e financimit të letrave me vlerë (SFTs) dhe për produktet derivate, të kleruara si në tregjet mbi banak (OTC - *over-the-counter*) ashtu dhe ato në mënyrë të centralizuar. Vetë CCR konsiderohet si një rrezik kompleks për t'u vlerësuar, pasi për shkak të natyrës së tij hibride, midis rrezikut të besueshmërisë dhe atij të tregut, ai varet si nga ndryshimet në besueshmërinë e palëve të treta, ashtu dhe nga lëvizjet në faktorët bazë të rrezikut të tregut. Bazel III prezanton kërkesa për kapital për të mbuluar rrezikun e Axxhustimit të Vlerës së Besueshmërisë (CVA), si dhe kërkesa më të larta kapitali për produktet e titullizuara.

Shtesat e reja mbrojtëse të rishikuara të kapitalit kërkojnë që bankat të mbajnë më shumë kapital dhe cilësi më të lartë të kapitalit, në krahasim me rregullat e Bazel II. Raportet e reja të likuiditetit sigurojnë që bankat të kenë fonde të mjaftueshme, në rast se ndodhin kriza të tjera të rënda për sistemin bankar. Bankave u është dhënë mjaft kohë që të zbatojnë këto ndryshime, me qëllim që të parandalojnë ngrirjen e papritur të huadhënies, ndërkohë që bankat përpiqen të përmirësojnë bilancet e tyre. Sipas Komitetit të Bazelit, një nga shkaqet themelore të krizës financiare ishte përdorimi i tepërt i levës lidhur me zërat e bilancit dhe ato jashtë bilancit, nga bankat sistemike, të cilat duket se ruajnë raporte të shëndetshme të kapitalit të bazuar në rrezik. Sipas rregullave të Bazel II, në kulmin e krizës globale, tregjet financiare detyruan bankat sistemike të reduktonin përdorimin e levës,

në një mënyrë të tillë që përforcoi trysninë mbi çmimet në rënie të aktiveve, d.m.th. të huave dhe letrave me vlerë. Ky proces i reduktimit të përdorimit të levës, e përkeqësoi qarkun shkak-pasoje midis humbjeve, gërryerjes së kapitalit të bankave dhe zvogëlimit të disponueshmërisë së huas. Korniza e Bazel III, si përgjigje ndaj kësaj situate, prezanton një raport leve të thjeshtë, transparent, jo të bazuar në rrezik, që vepron si një masë plotësuese e besueshme për kërkesat për kapital të bazuara në rrezik për sektorin bankar. Me fjalë të tjera, raporti i levës së kapitalit ka për qëllim të: a. kufizojë rritjen e tepruar të levës nga ana e bankave, për të shmangur destabilizimin e proceseve të reduktimit të saj, që mund të dëmtojnë sistemin dhe ekonominë; dhe b. përforcojë kërkesat e bazuara në rrezik me një masë "frenuese" të thjeshtë, e jo të bazuar në rrezik. Ndërsa rregullat mund të ndihmojnë në reduktimin e mundësisë së ndodhjes së krizave të ardhshme financiare, ato gjithashtu mund të kufizojnë rritjen ekonomike në të ardhmen. Kjo pasi huadhënia bankare dhe disponueshmëria e huas janë ndër shtytësit kryesorë të veprimtarisë ekonomike në ekonominë moderne. Rrjedhimisht, çdo rregull i projektuar për të kufizuar huadhënien ka të ngjarë të pengojë rritjen ekonomike, të paktën deri në një farë mase. Megjithatë, ajo që ka më shumë të ngjarë të ndodhë është që, si rregullatorët edhe pjesëmarrësit e tregut financiar, janë të gatshëm të pranojnë një rritje ekonomike pak më të ngadaltë, nëse kjo do përkthehet në një stabilitet më të madh dhe në një rënie të mundësisë për përsëritjen e ngjarjeve të viteve 2008-2009.

OBJEKTIVAT PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM



ALPHA BANK

- Më 5 qershor 2019, Alpha Bank Albania u angazhua në një veprimtari humane në Qendrën Sociale Tiranë, në bashkëpunim me vullnetarët e Kryqit të Kuq Shqiptar.
- Banka mbështeti financiarisht Projektin: “Mësohemi dhe edukohemi duke u argëtuar”, në shkollën 9-vjeçare “Pashko Vasa”, Shkodër.
- Banka mori pjesë në edicionin e 10-të të Panairit Shqiptar të Studimit dhe Punësimit, 30 prill – 2 maj.
- Alpha Bank Albania iu bashkua World Vision Albania në projektin: “Tungjatjeta”, duke mbështetur me shërbime të specializuara 36 fëmijë me aftësi të kufizuara në zona të thella të Librazhdit.
- Më 25 prill, banka ishte pjesë e nismës së organizuar nga Junior Achievement of Albania, “Leader for a Day”.

abi AMERICAN BANK OF INVESTMENTS

OBJEKTIVI 3

Bankës Amerikane të Investimeve mbështeti:

- Në 21 prill, Trail Running Albania, në vrapimin malor në Malin e Dajtit.
- Të gjitha ekipeve sportive përbërëse të Klubit Sportiv “Studenti”.
- ABI Bank dhuroi një automjet, i cili do të jetë në shërbim të komunitetit të Qendrës Sociale “Të Qëndrojmë së Bashku”. Gjithashtu dhuroi pajisje elektroshtëpiake për “Shtëpinë e Shpresës” në Shën Vlash, Durrës.
- Në datën 24 maj, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, ndërmoi nismën vullnetare të “Dhurimit të Gjakut”.

OBJEKTIVI 4

Banka mbështeti botimin e librit “Udhëtim në tri kohë” të profesorit të

njohur z. Adrian Civici.

OBJEKTIVI 5

Në dt. 17 maj, u organizua mbrëmja gala e përvitshme e organizuar nga aktivistët e komunitetit LGBT në Tiranë.

OBJEKTIVI 11, 15

ABI Bank, në vijim të mbështetjes së nismave që promovojnë vullnetarizmin dhe mbrojtjen e natyrës, përkrahu nismën e Fondacionit “OPTIMA”, për pastrimin e plazhit dhe pyllit të Darëzezës në Fier.

ART, SPORT, KULTURE

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti:

- Për të dytin vit radhazi turin e koncerteve: “Tinguj Kinemaje” të Orkestrës Simfonike të RTSH-së.
- “Rally Albania” 2019.
- Festivalin Ndërkombëtar të Teatrit të Kukullave, 25 maj – 1 qershor.
- Muzikalin: “ANNIE”, 8 qershor në Arturbina.
- Festivalin Ndërkombëtar të Vokalit Operistik: “Marie Kraja”, në datat 19 dhe 20 prill, në Qendrën Kulturore të Katedrales Ortodokse në Tiranë.
- Si sponsor gjeneral i koncertit të muzikantit Olen Çezari, me grupin e tij “International Clandestine Orchestra”, 23 – 24 prill, në Pallatin e Kongreseve.
- Koncertin e grupit “Ritfolk”, si rikthim në muzikën e bukur të viteve ‘90.
- Rudina podcast. Me Omer Kaleshin, piktorin sa shqiptar, aq turk dhe francez hapet cikli në YouTube “Shqiptarët e Mrekullueshëm”, një bashkëpunim i Bankës Amerikane të Investimeve dhe Rudina Xhungës me Dritare.net.
- “Nga e Para”, në Vizion +, një ndër formatet televizive më familjarë,
- “Ma jep dorën”, një tjetër program që transmeton optimizëm dhe shpresë.





Sponsorizoi organizimin e festës së maturës, një traditë tashmë disa vjeçare për qytetin e Vlorës dhe për Drejtorinë Arsimore Rajonale Vlorë.



OBJEKTIVI 3

Credins dhuron Inkubatorë për spitalin "Koco Gliozeni".

Credins Bank mbështet Kryqin e Kuq. Në datën 28 maj, në mjediset e Qendrës Sociale të degës Tiranë, u realizua një festë me 50 fëmijë jetimë që jetojnë në komunitet.

Festoi Bajramin me Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë, duke kaluar një drekë me të gjithë banorët e kësaj shtëpie.

OBJEKTIVI 9

Banka u nderua me certifikatë mirënjohjeje të qytetit nga Z. Xhelal Mziu, Kryetar i Bashkisë Kamëz, për kontributin e veçantë dhe veprimtarinë në dobi të qytetit Kamëz.

OBJEKTIVI 11

Credins Bank mbështet Bashkinë Skrapar në organizimin e eventit mbi hapjen e sezonit turistik 2019. Credins mbështet Agrobiznesin dhe promovoi "Bankën Lëvizëse" dhe organizoi takime rajonale me fermerët e zonave rurale në të gjithë Shqipërinë.

Në festën e 1 Qershorit, fëmijët e stafit të Bankës Credins, dhuruan libra për bashkëmoshatarët e tyre në Shtëpitë e Fëmijëve në qytetet e Shkodrës, Durrësit dhe Korçës.

OBJEKTIVI 17

Credins Bank u bë pjesë e tri


veprimtarive:

- Në datat 30 prill - 2 maj, pjesë e Panairit "Work and Study".
- Duke investuar në punësimin e të rinjve dhe studentëve të sapo diplomuar, Dita e Karrierës 2019, në datën 18 prill, Fakulteti i Ekonomisë në Universitetin e Tiranës.
- Panairi i 6-të i karrierës, në 24 prill, te Epoka University
- Banka Credins mbështeti me sukses dhe këtë vit konkursin Kombëtar "Ide të Gjëlbera", në bashkëpunim me Partners Albania for Change and Development.
- Credins Bank, mbështeti forumin studentor me temë: "Novacioni në Sistemin Financiar Shqiptar", organizuar me studentët e Departamentit të Ekonomisë & Financës, të Universitetit European të Tiranës.

KULTURË ART DHE SPORT

Credins Bank mbështeti:

- Edicionin e dytë të vrapimit malor në Malin e Dajtit: "Dajti Trail Running", 21 prill
- Koncertin e këngëtarëve Soni Malaj & Majk, organizuar nga Bashkia Tiranë në Amfiteatrin e Liqenit të Tiranës.
- Bashkinë e Tiranës dhe Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, në promovimin e qytetit dhe artit në Tiranë.
- "Albania Climbing Festival", veprimtari për disiplinën "Climbing", viti i 5-të organizuar nga Rock Tirana Climbing Gym, 3 - 5 Maj, në Bovillë, Brar.
- "Albanian Open" event i cili këtë vit përkoi dhe me 20-vjetorin e krijimit të Aeronautikës Shqiptare, 8 - 11 maj, Vlorë, me pjesëmarrjen e më shumë se 70 pilotëve nga e gjithë bota.
- Koncertin "Mbrëmja e Romanës", të organizuar në Sallën e Koncerteve të Fakultetit të Arteve, në nderim të artistit Tonin Arapi.
- Kampionatin e dytë Ndërkombëtar të Taekwondo.



• Koncertin e organizuar nga Bashkia Tiranë, në datën 20 qershor, në Amfiteatrin e liqenit.



Në 19-21 prill Fibank Albania sponsorizoi festivalin folklorik "Vratsa Spring" në Vrasta, Bullgari. Kjo pjesmarrje u bë e mundur në sajë të kontributit që Fibank Albania ofroi në favor të shoqatës kulturore Skampa.

Fibank mirëpret studentë për të zhvilluar praktikat profesionale dhe mësimore, jo vetëm në qytetin e Tiranës, por edhe në qytete të tjera. Programi i praktikës bazohet në kuadër të bashkëpunimit disavjeçar me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Bazuar në vlerësimin e performancës së praktikanteve, përzgjedhjen më të mirët për rekrutim në pozicionet vakante që hapen në Fibank.

Në datën 9 maj, në qytetin e Lezhës u zhvillua "Festa e Luleve" organizuar në Restorant Rapsodia dhe me mbështetjen e Fibank.

Fibank paraqitet me degën e re, e cila është e 4-ta në Tiranë e 14-ta për të gjithë rrjetin Fibank Albania. Organizoi më 6 qershor trajnimin "Marrëdhënie pune" për kategorinë e menaxhimit të mesëm "Shefi i departamenteve dhe menaxherët e degëve", nga kompania e trajnimit profesional "EPPC Albania & Kosovo".

"Financim i shpejtë për pushime", një produkt me 0 % interes në bashkëpunim me Vas Tour Operator ose agjencitë nënkontraktore të saj.

Fibank & Booking.com një partneritet unik. Nëse e rezervon në faqen <http://travel.fibank.al>, klienti rimbursohet në llogari deri në 7% të shumës.



OBJEKTIVI 3

Për të 10-in vit rradhazi, punonjësit e Intesa Sanpaolo Bank Albania morën pjesë në nismën e dhurimit vullnetar të gjakut. Banka, për të rritur ndërgjegjësimin mbi Dhuruesit Vullnetarë të Gjakut, kreu një komunikim me klientët dhe publikun përmes ekraneve të ATM-ve dhe faqeve zyrtare të bankës në mediat sociale.

OBJEKTIVI 4


Banka mbështeti AIESEC në Shqipëri në organizimin e SpringCo2019 (Student Conference), 2 prill.

• Dita Botërore e Librit dhe të Drejtave Autoriale, është një datë simbolike për letërsinë botërore.

Banka ndihmoi organizimin e Festës së Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë, në kampusin universitar, për 26 vjetorin e themelimit, 24 prill 2019.

• Banka mbështeti për të dytin vit rradhazi Konferencën Studentore: "Globalizimi në IN.E.AR deri në limitet e tij", 25 prill. Fituesja e Çmimit të Parë të punimit më të mirë "Strategjia e Planifikimit të Zgjuar", nisi një praktikë mësimore të paguar pranë Intesa Sanpaolo Bank Albania.

• Dy fitueseve të Konkursit të Esësë të Javës së Parasë: "Denominimet, shembuj nga Historia dhe Rasti Shqiptar", iu ofrua Praktikë Mësimore e paguar pranë Intesa Sanpaolo Bank Albania.



OBJEKTIVI 5

Dita Ndërkombëtare e vajzave në ICT - synon të inkurajojë dhe të fuqizojë vajzat dhe gratë e reja që marrin në konsideratë studimet dhe të kenë një karrierë në fushën e ICT-së, duke u mundësuar kompanive teknologjike dhe vajzave që të përfitojnë nga pjesëmarrja më e madhe e femrave në sektorin e ICT, 25 prill.

OBJEKTIVI 8

Banka ishte pjesë e Panairit të 6-të të Karrierës, organizuar nga Universiteti Epoka, 24 prill.

- Dita Botërore e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë me fokus në promovimin e sigurisë shëndetit dhe integritetit, 28 prill.

- Banka ishte pjesë e "Panairit të Punës 2019 - Dita e Biznesit në UET" në 16 maj dhe në UMT në 29 maj.

OBJEKTIVI 9

Dita Botërore e Kreativitetit dhe Inovacionit (#WCID) është e pozicionuar 6 ditë pas ditëlindjes së Leonardo da Vincit dhe 1 ditë para Ditës Ndërkombëtare të Nënës Tokë, 21 prill 2019.

OBJEKTIVI 15

Dita Ndërkombëtare e Tokës, 22 prill. Toka dhe ekosistemet e saj janë shtëpia jonë.

OBJEKTIVI 13

Banka ndërmoi një nismë ndërgjegjësuese një javore për të gjithë kolegët dhe klientët e saj, përmes kartolinave të fokusuar në përcjelljen e mesazheve rreth ndikimit që ndotja e ajrit ka sot në mjedis, 5 qershor.

OBJEKTIVI 10 & 16

Në 20 qershor, banka për të rritur ndërgjegjësimin mbi problematikën e Refugjatëve kreu një komunikim me klientët

dhe publikun përmes ekraneve të ATM-ve, footer në shkëmbimin e e-maileve, faqen e website, faqeve zyrtare të bankës në mediat sociale.

ARTI DHE KULTURA

Në 11 – 20 qershor, Intesa Sanpaolo Bank Albania përkrahu projektin studentor: "E DUA TEATRIN" ku studentët të 4 fakulteteve të ndryshme (Ekonomik, Mjekësisë të Universitetit "Marin Barleti & Fakultetit të Histori-Filogjisë) vunë në skenë shfaqje të cilat i përgatitën vetë, me ndihmën e regjisorëve të rinj

**OBJEKTIVI 3**

Banka mbështeti Spitalin Rajonal Krujë me një aparaturë Echo. Një tjetër projekt po kaq i rëndësishëm në mbështetje të shëndetësisë ishte dhe pajisja me disa aparatura e laboratorit të Spitalit Lezhë.

- Banka mbështeti fondacionin "Ti je një luledielli", në organizimin e një feste më rastin e 1 Qershorit, ku përveç argëtimit nuk munguan edhe dhuratat që stafi i bankës dhuroi për fëmijët.

OBJEKTIVI 4




Për të katërtin vit radhazi banka vijoi mbështetjen e projektit "Qyteti i Lexuesve", i cili synon krijimin e hapësirave të reja letrare për edukimin e brezave të rinj.

OBJEKTIVI 9

Raiffeisen Bank prej 4 vitesh mbështeti konferencën InfoCom, e cila këtë vit shënoi edicionin e saj të 10-të, InfoCom X - the Anniversary, 24 prill.

OBJEKTIVI 11

Në Ditën Ndërkombëtare të



Ndërgjegjësimet për Autizmin, Raiffeisen Bank mbështeti Fondacionin "Fëmijët Shqiptarë", në publikimin e një manualit të rëndësishëm terapeutik për prindërit në formatin libër dhe DVD.

- Në kuadër të projektit të bashkëpunimit me Drejtorinë Arsimore Rajonale Tiranë, banka mundësoi pajisjen e 5 shkollave 9 vjeçare në kryeqytet me nga një dhomë relaksi, të cilat do t'u vijë në ndihmë fëmijëve me aftësi ndryshe që janë integruar në këto shkolla.

- Në 2 prill u organizua në Pallatin e Kongreseve edicioni i dytë i Ballos Vjeneze, me mbështetjen e Raiffeisen Bank. Një pjesë e të ardhurave të mbledhura nga ky event i shkuan Fondacionit "Ti je një luledielli".

- Mbështeti organizimin e "South Outdoor Festival" në Himarë.

Raiffeisen mbështeti Qendrën "Act for Society" në projektin "Power Up Community 2".

- Raiffeisen Bank mbështeti Bashkinë e Tiranës në projektin e pajisjes së sheshit "Emil Lë Grand" me dy terrene të reja sportive.

- Mbështeti Gjimnastradën në veprimtarinë social-kulturore: "E Ardhmja dhe Shpresa".

OBJEKTIVI 13

Në bashkëpunim me Forumin e Mendimit të Lirë përmes Korpusit Shqiptar të Vullnetarëve, u zhvilluan disa aksione për pastrimin e zonave bregdetare nga papastërtitë. Zonat ku u zhvilluan këto aksione ishin Plazhi i Spillesë, i Tales në Lezhë, plazhi i Zvërnecit, parku i Vilunit, si dhe së fundmi Parku Kombëtar i Llogarasë.

- Më shumë hapësira të gjelbra në kryeqytet dhe kjo falë mbështetjes që Raiffeisen Bank i dha Bashkisë së Tiranës në projektin e mbjelljes së 500 pemëve në Tiranë.

ART DHE KULTURË

Raiffeisen mbështeti:

- Edicionin e dytë të festivalit: "Ballkan Jazz showcase", 29 - 30 prill.

- Edicionin e tretë të: "Swing Marathon", 12 orë muzike Jazz e viteve '50-'60 nga Tirana në Shkodër u organizuan nga Hemingway Fan Club Albania.

- Edicionin e dytë të: Color Day Festival.

UNIONBANK

OBJEKTIVI 8

Në datën 24 prill, Union Bank mori pjesë në Ditën e Karrierës, të organizuar pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës.

- Union Bank dhe Kolegji Universitar "Luarasi" zyrtarizuan në 14 qershor bashkëpunimin mes tyre për ofrimin e programeve të praktikës mësimore për studentët e këtij universiteti. Marrëveshja mes dy institucioneve u firmos nga z. Gazmend Kadriu, Drejtor i Përgjithshëm i Union Bank dhe Prof. Dr. Et'hëm Ruka, Rektor i Kolegjit Universitar "Luarasi".



Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) feston 20-vjetorin e themelimit

E krijuar 20 vite më parë (mars 1999), AAB promovon standardet më të fundit bankare të anëtarëve të saj, zhvillimin, stabilitetin dhe efektshmërinë e sektorit bankar shqiptar në përgjithësi, dhe në partneritet me aktorët e sektorit publik dhe privat, kontribuon për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe për të diskutuar çështjet kyçe të industrisë, si dhe përcaktimin e strategjive të përbashkëta për sektorin financiar shqiptar.

Investimeve, Federata Evropiane Bankare, institucione financiare kombëtare dhe ndërkombëtare, shoqatat e bankave të rajonit, përfaqësues të organizatave jofitimprurëse, nga universitetet dhe media. Të pranishëm Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, znj Anila Denaj, dhe Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrësve Eduart Shalsi. Këtë përvjetor e

për pjesëmarrjen në këtë organizim. Në vijim, u mbajtën fjalë përshëndetëse nga Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, znj. Anila Denaj, znj. Maryam Salim, Përfaqësuesja e Përhershme e



Bankës Botërore në Shqipëri, dhe z. Istvan Lengyel, Sekretar i Përgjithshëm, Banking Association for Central and Eastern Europe (BACEE), i cili i dhuroi AAB-së një diplomë në emër të BACEE për bashkëpunimin.

Më datë 13 Maj, Shoqata Shqiptare e Bankave organizoi ceremoninë e festimeve të 20-vjetorit të themelimit të saj. Në ceremoni morën pjesë personalitete të ndryshme me kontribut në sektorin bankar, përfaqësues nga ministri të ndryshme, Banka e Shqipërisë, Banka Botërore, UNDP, BERZH, Banka Evropiane e

nderuan dhe përfaqësues të organizatave të huaja, partnere, me të cilat AAB bashkëpunon ndër vite.

Z. Silvio Pedrazzi, Kryetar i AAB-së dhe Drejtor i Përgjithshëm i Intesa Sanpaolo Bank Albania uroi mirëseardhjen të pranishmëve dhe falënderoi



Ministrja Denaj në fjalën e saj vlerësoi kontributin e çmuar të sistemi bankar në Shqipëri në

rritjen ekonomike, duke qenë një mjet i rëndësishëm i nxitjes së kursimeve të shqiptarëve, por edhe rritjes së ekonomisë së vendit nëpërmjet kreditimit. Ministrja vuri theksin në domosdoshmërinë



e kthimit të kreditim të nivelin e pritsëm, pasi "fuqizimi i kreditimit është një domosdoshmëri jo vetëm për zhvillimin ekonomik



e të qëndrueshëm të vendit, por është edhe një aktivitet bazë i rëndësishëm për vetë bankat".

Mbrëmja vijoi nën një atmosferë festive me muzikë dhe përshëndetje mes të ftuarve.



Shoqata Shqiptare e Bankave organizon konferencën me temë “Bankat për zhvillim të qëndrueshëm”

Në datën 14 maj 2019 u zhvillua Konferenca e 3-të e AAB-së me temë “Bankat për zhvillim të qëndrueshëm”. Në këtë konferencë, pjesëmarrës ishin përfaqësues nga bankat anëtare. Gjithashtu, morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka e Shqipërisë, Banka Botërore, UNEP FI, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, (BERZH), Banka Evropiane e Investimeve, Federata Evropiane Bankare, shoqatat e bankave të rajonit, përfaqësues të organizatave jo-fitimprurëse dhe rretheve akademike dhe media.



Konferenca u çel nga z. Silvio Pedrazzi, Kryetar i AAB-së dhe Drejtor i Përgjithshëm i Intesa Sanpaolo Bank Albania, si dhe u përshëndet nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, në fjalën e mbajtur për të pranishmit, duke nënvizuar progresin e bërë, theksoi se zhvillimi i sektorit bankar – dhe i sistemit financiar në përgjithësi – nuk ka qenë linear: sfidat me të cilat ai është përballur kanë qenë të vazhdueshme dhe të formave të ndryshme. Këto sfida kanë kërkuar kujdes dhe vendimmarrje aktive, inteligjente e kurajoze. Ai shprehu bindjen se eksperiencia e përbashkët do të ndihmojë në vendimmarrjen në



PAKETA E
BIZNESIT



 **UNIONBANK**
Banka që dua

Zgjeroni biznesin tuaj!

- Kredi nga 30.000 - 400.000 Euro
- Shërbime bankare me kosto 50% më të ulëta

KREDI DERI NË
400.000 Euro

 unionbank.al

 0800 0800



të ardhmen.

Me tej, konferenca u organizua në dy panele. Paneli i parë u drejtua z. Seyhan Pencabligil, Drejtor i Përgjithshëm dhe Anëtar Bordi, Banka Kombëtare Tregtare, dhe u përqendrua në rolin dhe përgjegjësitë për një të ardhme të qëndrueshme. Znj. Puleng Tumelo Ndjwili-Potele, Koordinatorë për Projektet Bankare, UNEP FI, prezantoi "Parimet për Bankingun e Përgjegjshëm: Një mjet për udhëhequr kreditimin që kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm". Z. Dejan Vasiljev, ekonomist kryesor, BERZH, u fokusua te financat dhe rritja e qëndrueshme.

Z. Sebastien de Brouwer, Oficer i lartë për politikat, Federata Evropiane Bankare, foli mbi rolin e bankave në financimin e qëndrueshëm dhe perspektivën evropiane. Z. Alessandro Bragonzi, përfaqësues i EIB-së për Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë Veriore, solli eksperiencën se si grupi i EIB-së financon një të ardhme të qëndrueshme. Bankat në botën sfiduese të ndërmjetësimi financiar u prezantua nga z. Milan Mirjanic, Partner i Asocuar i McKinsey.

Pjesëmarrësit në panelin e dytë të konferencës trajtuan sfidat e bankingut në rajon nën moderimin e z. Sebastien de Brouwer, Oficeri i lartë për politikat në Federatën Evropiane Bankare. Më konkretisht, z. Pierfrancesco Gaggi, Drejtues i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Shoqata e Bankave në Itali, prezantoi zhvillimin e sektorit bankar për përforcimin e rimëkëmbjes. Z. Vladimir Vasic, Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës së Bankave të Serbisë, solli eksperiencën e Serbisë mbi tregun e NPL-ve dhe rritjen e kreditimit, dhe znj. Charikleia Apalagaki, Sekretare e Përgjithshme e Shoqatës Helenike të Bankave prezantoi këndvështrimin mbi qeverisjen dhe balanca ndërmjet efektivitetit dhe sigurisë në Greqi. Konsolidimi i sektorit bankar shqiptar u prezantua nga z. Silvio Pedrazzi, Kryetar i AAB-së dhe Drejtor i Përgjithshëm i Intesa Sanpaolo Bank Albania, i cili mbylli dhe punimet e kësaj konference.



AAB AKTIVITETE

Takimi i Kryetarit të AAB-së me përfaqësuesit e medias

Më 24 prill, me ftesë të z. Silvio Pedrazzi, Kryetar i AAB-së dhe në prani të z. Spiro Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm i AAB-së, u mbajt një takim me përfaqësues të medias që mbulojnë lajmet ekonomike. Takimi u zhvillua në kuadër të marrëdhënieve të koordinimit të qëndrueshëm e të frytshëm me mediat, me synimin për një informim më të mirë.



Takim i Guvernatorit Sejko me sektorin bankar për të diskutuar mbi: "Rolin e industrisë bankare në zhvillimin e ardhshëm të Shqipërisë".

Më 29 maj, në mjediset e Bankës së Shqipërisë u organizua një takim mbi: "Rolin e industrisë bankare në zhvillimin e ardhshëm të Shqipërisë", me pjesëmarrjen e zyrtarëve të lartë të Bankës së Shqipërisë, drejtues të bankave tregtare dhe përfaqësues nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Grupi i Bankës Botërore.



Takimi vjetor i Grupit të Përdoruesve të SWIFT-it ("UGM")

Më 9 maj u organizua takimi vjetor i UGM-së, i cili u zhvillua në dy pjesë dhe u ndoq nga përfaqësues të bankave anëtare, si: Drejtorët e Sigurisë së Informacionit (CISO); Drejtorët/ Menaxherët e TI-së; kontaktet kryesore të SWIFT-it dhe përfaqësues të Bankës së Shqipërisë.



Takim-diskutimi mbi Bankingun e Hapur & PSD2

Më 12 qershor, AAB dhe Facilitation, një shoqëri shërbimesh dhe programesh të TI-së, e përqendruar në ofrimin e shërbimeve të plota në Industrinë Bankare dhe Financiare, organizuan bashkërisht një seminar mbi Bankingun e Hapur dhe PSD2 (Direktiva e Rishikuar e Shërbimeve të Pagesave në BE). Përfaqësues nga bankat tregtare, shoqëritë Facilitation dhe RedHat, morën pjesë në këtë takim.



Edukimi Financiar

AAB nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me "Finance in Motion GmbH" për bashkë-sponsorizimin e shtypjes së një broshure edukuese për huan bujqësore dhe shpërndarjen e broshurës te grupe të ndryshme interesi në Shqipëri. Kjo broshurë edukuese trajton parimet bazë dhe rreziqet që lidhen me kreditimin e bujqësisë. Materiali u përshtat sipas specifikave të vendit, me ndihmën e bankave anëtare. Broshura do të jetë në dispozicion në gjuhën shqipe dhe angleze.

TRAJNIME

AAB organizon trajnime

Prill - Qershor 2019

Trajnim për Transformimin e Zhdërvjellët të Biznesit
1 - 2 prill, në bashkëpunim me AIEEx.

Trajnim për Bankingun për Individë dhe kanalet e reja të shpërndarjes dhe e-banking, organizuar më 6-8 maj.

Trajnim për Ekipet Udhëheqëse, 20 - 21 maj, në bashkëpunim me AIEEx - Instituti Austriak i Ekselencës dhe i drejtuar nga Larissa Winter, MBA.

Metodologjia e trajnimit "Points of You™" - Më 21 maj, AAB në bashkëpunim me Institutin Austriak të Ekselencës organizoi një sesion informues prej 2 orësh, lidhur me metodologjinë më të re të trajnimit, Points of You™, që instituti mund të ofrojë në Shqipëri. Ky prezantim u realizua nga trajnerja kryesore, Dr. Larissa Winter.

Takim-Diskutimi mbi Pajtueshmërinë në Tregtisë Ndërkombëtare, 18 qershor, i organizuar nga ICC Albania, dhe i mbështetur nga AAB.

Trajnim mbi kuptimin dhe auditimin e Sigurisë Kibernetike, 20-21 qershor, në bashkëpunim me AIIA.

Takim-diskutimi mbi: "Bazat e Bankingun e Financave të Tregtisë Dokumentare Ndërkombëtare për zyrën mbështetëse (back office)", 25-26 qershor, në bashkëpunim me ICC Albania dhe mbështetur nga BERZH.

Trajnim mbi sigurinë teknike dhe vënien në funksionim të instrumenteve gjurmuese. Më 9 dhe 20 qershor, AAB siguroi pjesëmarrjen e më shumë se 25 zyrtarëve të sigurisë nga bankat anëtare, për trajnimin: "Mbi sigurinë teknike dhe drejtimin e automjeteve për në aeroport", të organizuar nga Tirana International Airport.

AAB vijoi bashkëpunimin me Institutin Austriak të Ekselencës (AIEEx), duke ofruar më shumë trajnime në gjuhën shqipe, në rajone të ndryshme të Shqipërisë.

- **Kapacitetet e shitjes dhe menaxhimi i shitjeve** - 9-10 prill në Korçë dhe më 25-26 qershor në Gjirokastër.
- **Motivimi dhe drejtimi i një ekipi të suksesshëm** - më 17-18 prill në Fier, më 8-9 maj në Lezhë dhe më 29-30 maj në Korçë.

